



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

NYJA E GORDIANIT: PENGESAT E KOSOVËS PËR ANËTARËSIM
NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE TË SIGURISË

RASTI I INTERPOL-it



Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autorë: Leonora Aliu dhe Plator Avdiu

Redaktimi i brendshëm: Florian Qehaja

Redaktimi i jashtëm: Shpend Kursani

Nëntor 2016

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat për pronësi intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes, ose të transmetohet në ndonjë formë apo me ndonjë mjet elektronik, mekanik ose ndryshe, pa lejen paraprake të botuesit.

Ky projekt është financuar nga granti i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Opinione, gjetjet, përfundimet apo rekomandimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e KFOS-it.



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



KFOS
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

**NYJA E GORDIANIT: PENGESAT E KOSOVËS PËR ANËTARËSIM
NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE TË SIGURISË**

RASTI I INTERPOL-it

Nëntor 2016
Prishtinë

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	6
HYRJE.....	8
METODOLOGJIA	9
PJESA 1 – BASHKËPUNIMI RAJONAL POLICOR I KOSOVËS	10
1.1. Konteksti i përfaqësimit dhe anëtarësimit të Kosovës në nismat rajonale të sigurisë	10
1.2. Zbatimi i Marrëveshjes së Brukselit për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal.....	15
PJESA 2 – RASTI I INTERPOL-IT	18
2.1. Marrëdhëniet e Kosovës me INTERPOL-in përmes UNMIK-ut	19
2.2. Procesi i anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL	22
2.3. Skenarët për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL	29
2.3.1. Skenari i parë	29
2.3.2. Skenari i dytë	31
REKOMANDIME	34
BIBLIOGRAFIA	37

LISTA E SHKURTESAVE

AC	Karta e Adriatikut
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë
EUROJUST	Njësia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim Gjyqësor
EUROPOL	Agjencia e Bashkimit Evropian për Zbatim të Ligjit
FRONTEX	Agjencia Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian
GJND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
ILECU	Njësia për Koordinim Ndërkombëtar për Zbatim të Ligjit
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale
KBR	Këshilli për Bashkëpunimin Rajonal
KS	Këshilli i Sigurimit
MARRI	Nisma Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë
MD	Ministria e Drejtësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PCCSEE	Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore
PK	Policia e Kosovës
PP	Procesi i Pragës
PSOTC	Qendra Trajnuese për Përkrahjen e Operacioneve Paqësore
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
RACVIAC	Qendra për Bashkëpunim në fushën e Sigurisë
RAI	Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit
SECI	Nisma për Bashkëpunim në Evropën Juglindore
SEDM	Ministeriali i Mbrojtjes së Shteteve të Evropës Juglindore
SEEC	Forumi i Ballkanit Perëndimor për Mbrojtje
SEECP	Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore
SEEPAG	Grupi për Këshillime të Prokurorëve në Evropën Juglindore
SEESAC	Kontrolli i Armëve të Vogla në Evropën Juglindore
SELEC	Qendra për Zbatim të Ligjit në Evropën Juglindore
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
UNMIK	Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë
WBPN	Rrjeti i Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Sfidat:

- Qeveria e Kosovës nuk ka arritur ta shfrytëzojë sa duhet Marrëveshjen e Brukselit për bashkëpunim rajonal të arritur me Serbinë në kuadër të dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian në kontekst të anëtarësimit të Kosovës me të drejta të plota në nismat rajonale të sigurisë. Ajo ka siguruar vetëm statusin e “pjesëmarrësit” apo “vëzhguesit” në këto nisma.
- Qeveria e Kosovës nuk ka ndërmarrë hapa konkret për të avancuar në nismat rajonale të sigurisë nga statusi i anëtarit të “asociuar” apo “vëzhguesit” në anëtarë me të drejtë vote.
- Institucionet kosovare nuk janë palë zyrtare në marrëdhëniet me INTERPOL-in, por varen kryekëput nga misioni i UNMIK-ut. Ky i fundit kritikohet se nuk ndan në mënyrë të plotë me institucionet përkatëse të Kosovës informacionet që merr nga INTERPOL-i.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar policor u bë prioritet i institucioneve kosovare tek në vitin 2015, kur u dorëzua për të dytën herë aplikacioni për anëtarësim në INTERPOL. Diskursi politik në Kosovë sa i përket anëtarësimit në INTERPOL ka mbetur në nivelin deklarativ, por pa rezultate konkrete.
- Deri më tash nuk ka pasur bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës për përgatitjen e vendit drejt anëtarësimit në INTERPOL.
- Kërkesa e Kosovës për anëtarësim në INTERPOL ka ngelur tek Sekretari i Përgjithshëm i INTERPOL-it. Ajo nuk ka kaluar ende për shqyrtim në Komitetin Ekzekutiv të INTERPOL-it dhe as në Asamblenë e Përgjithshme të INTERPOL-it.
- Aplikacioni i Kosovës për anëtarësim nuk pritet të shqyrtohet nga ana e INTERPOL-it para dy-tri viteve të ardhshme. Kjo për shkak se INTERPOL-i ka krijuar një mision vlerësimi për të shqyrtuar nëse Kosova dhe vende të tjera kandidatë për anëtarësim kanë përmbushur kushtet për anëtarësim në INTERPOL.
- Serbia, e ndihmuar nga aleati i saj, Rusia, e ka identifikuar INTERPOL-in si betejën e radhës diplomatike kundër Kosovës. Ajo e ka ngritur këtë çështje në mbledhjet e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara gjatë diskutimeve për Kosovën.

Përparësitë:

- Për anëtarësim në INTERPOL nuk është kusht për Kosovën anëtarësimi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Diplomacia kosovare duhet të argumentojë në pikëpamje juridike e policore të drejtën për anëtarësim në INTERPOL.
- Mendimi këshillëdhënës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe argumentet juridike me rastin e pranimin të Kosovës në UEFA e FIFA shërbejnë si përparësi.
- Shtetet përkrahëse të Kosovës (Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Gjermania, Franca dhe vende të tjera) kanë arsyetuar në mënyra të ndryshme rëndësinë e anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL. Gjetjet e këtij hulumtimi dëshmojnë se në radhët e mbështetësve të Kosovës argumentet janë shumë më të mëdha dhe përkrahja është shumë më e dukshme sesa në rastin e UNESCO-s.
- Nevoja e Kosovës për anëtarësim në INTERPOL është e madhe, veçanërisht për parandalimin dhe luftimin e krimeve që tejkalojnë kufijtë shtetërorë. Lufta kundër terrorizmit apo ekstremizmit të dhunshëm dhe krimeve të tjera të dimensionit trans-nacional kërkon bashkëpunim ndërkufitar dhe ndërkombëtar në mes të shteteve dhe organizatave ndërkombëtare për zbatimin e ligjit.

HYRJE

Përpjekjet e institucioneve të Kosovës në funksion të anëtarësimit të vendit në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë, me theks të veçantë në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale – INTERPOL kanë nxjerrë në sipërfaqe se ato nuk kanë qenë të suksesshme deri më tash. Pothuajse që prej shpalljes së pavarësisë së Kosovës (17 shkurt 2008) angazhimi i institucioneve kosovare ka ngelur më tepër në kufijtë e deklarimeve politike sesa të veprimeve konkrete për anëtarësim në organizatat rajonale e ndërkombëtare të fushës së sigurisë. Institucionet përkatëse të Kosovës nuk kanë dëshmuar vendosmëri politike për të vendosur marrëdhënie zyrtare dhe të drejtpërdrejta me INTERPOL-in, derisa urë lidhëse vazhdon të mbetet misioni i UNMIK-ut.

Ndonëse së voni ka pasur lëvizje nominale në funksion të dërgimit të aplikimit për anëtarësim, institucionet vendore megjithatë kanë qenë të pakoordinuara në mes vete për udhëheqjen e këtij procesi dhe aktivitetet diplomatike që duhet ndërmarrë për shtyrjen përpara të agjendës së anëtarësimit në të. Lëvizje pak më shumë pozitive, por ende të kufizuara, janë vërejtur në anëtarësimet në organizatat rajonale të sigurisë, diku me të drejta të plota, diku si pjesëmarrëse. Dobësive të brendshme i kontribuojnë pengesat e jashtme, siç është mosnjohja e shtetit të Kosovës nga Serbia dhe nga një pjesë e shteteve anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Serbia ka vazhduar të pengojë pjesëmarrjen dhe anëtarësimin e Kosovës në shumicën e nismave rajonale të sigurisë. Kjo ka ndodhur pavarësisht Marrëveshjes së Brukselit për bashkëpunim rajonal, përmes së cilës nominalisht ishte gjetur modaliteti që Serbia të mos e pengojë Kosova për anëtarësim në organizatat rajonale.

Pjesa e parë e këtij hulumtimi trajton kontekstin e përfaqësimit dhe anëtarësimit të Kosovës në nismat rajonale dhe evropiane të sigurisë si dhe bashkëpunimin policor të Kosovës me shtetet tjera. Në këtë pjesë shqyrtohet rëndësia e anëtarësimit të Kosovës në këto nisma, sfidat e deritashme dhe roli i Marrëveshjes së Brukselit për bashkëpunim rajonal mes Kosovës dhe Serbisë. Ndërkaq, pjesa e dytë e raportit analizon mundësitë, pengesat dhe përparësitë e Kosovës për anëtarësim në INTERPOL. Marrëdhëniet e Kosovës me INTERPOL-in, të cilat zhvillohen në mënyrë të tërthortë përmes UNMIK-ut, mosbashkëpunimi në nivel të duhur ndërmjet institucioneve kosovare për anëtarësim në INTERPOL, pengesat nga Serbia dhe aleatët e saj për të bllokuar Kosovën të anëtarësohet në INTERPOL, si dhe mbështetja e këtij procesi nga shtetet përkatëse të Kosovës përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kësaj pjesë.

Për të avokuar dhe ofruar zgjidhjet për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL, ky hulumtim ka propozuar dy skenarë që do të mund ta shpinin Kosovën drejt anëtarësimit në INTERPOL. Në skenarë jepen arsyet për nevojën e menjëhershme të Kosovës për anëtarësim në INTERPOL me qëllim të zbatimit të ligjit, si dhe parandalimit e luftimit të krimeve që tejkalojnë kufijtë shtetërorë, ku Kosova mund të jap kontributin e saj. Raporti, gjithashtu, përmban një pako me rekomandime konkrete në drejtim të përfaqësimit dhe anëtarësimit të Kosovës në organizatat rajonale e ndërkombëtare të sigurisë, me theks të veçantë në INTERPOL.

METODOLOGJIA

Për hartimin e këtij raporti janë përdorur metodat kualitative. Të dhënat kualitative përfshijnë analizimin e dokumenteve të ndryshme me karakter juridike politik, raporteve të organizatave vendore e ndërkombëtare dhe burime të tjera nga institucionet publike. Në këtë drejtim, janë shtjerrë dokumentet e ndryshme të INTERPOL-it lidhur me fushë-veprimtarinë dhe për funksionimin e mekanizmave të saj në praktikë. Gjithashtu, dokumentet e institucioneve të Kosovës, duke përfshirë legjislacionin dhe strategjitë vendore në fushën e sigurisë dhe në veçanti për bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar policor janë marrë në shqyrtim për realizimin e këtij hulumtimi.

Të dhënat shtesë janë grumbulluar nga realizimi i intervistave me përfaqësuesit e këtyre institucioneve në Kosovë: Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë e Kosovës, Komisionin e Kuvendit të Kosovës për Punë të Brendshme dhe Siguri, misionin UNMIK dhe me njohës të së drejtës ndërkombëtare

Gjithashtu, grumbullimi i të dhënave të këtij hulumtimi është plotësuar nga monitorimi i aktiviteteve të institucioneve të Kosovës në raport me procesin e anëtarësimit në nismat rajonale e ndërkombëtare të bashkëpunimit policor dhe në INTERPOL. Në fund, edhe arkivat e mediave të Kosovës, të cilat kanë raportuar për bashkëpunimin rajonal policor të Kosovës dhe për procesin e anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL, e kanë plotësuar edhe më shumë përmbajtjen e këtij hulumtimi.

PJESA 1 – BASHKËPUNIMI RAJONAL POLICOR I KOSOVËS


1.1. Konteksti i përfaqësimit dhe anëtarësimit të Kosovës në nismat rajonale të sigurisë

Trendët e ngritjes së krimit ‘përtej kufijve’, si krimi i organizuar dhe rastet e terrorizmit apo ekstremizmit të dhunshëm kanë ngritur nevojën që shtetet e ndryshme, e sidomos ato me kufijtë e përbashkët, të bashkëpunojnë si në këmbim të informacioneve, ashtu edhe në aspektin operativ me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit. Nevoja për bashkëpunim në luftën kundër krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor daton qysh nga viti 1995, pas luftërave të njëpasnjëshme që ky rajon i Evropës Juglindore kishte pësuar.

Kështu kishte nisur edhe vala e krijimit të nismave rajonale për siguri. Ndër të parat ishin krijuar menjëherë pas përfundimit të luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë më 1996, si Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECF), Nisma për Bashkëpunim në Evropën Juglindore (SECI) dhe Ministeriali i Mbrojtjes së Shteteve të Evropës Juglindore (SEDM). Vala e dytë kishte nxitur në krijimin e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore, aktualisht i njohur si Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (KBR).¹ Ky Këshill ishte krijuar menjëherë pas luftës së fundit në Kosovë dhe ndryshimeve politike në Serbi e Kroaci pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Që nga viti 2012 në Evropën Juglindore është krijuar një rrjet mjaft kompleks i nismave rajonale të sigurisë. Numri i tyre përfshin 33 sosh (shih figurën 1), prej nismave rajonale të mbrojtjes e ato policore deri te nismat rajonale në fushën e drejtësisë dhe të punëve të brendshme.

1 (Prezelj, 2013).

Fig 1. Rrjeti i nismave rajonale të sigurisë në Evropën Juglindore²



Kosova, si pjesë e Ballkanit Perëndimor, bën pjesë në atë që ndryshe njihet si rajon i përshtatshëm për aktivitete të krimit të organizuar.³ Ky fakt e bën edhe më të rëndësishme nevojën e bashkëpunimit mes shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe përfshirjen e barabartë të tyre në nisma dhe organizata rajonale, por edhe ato evropiane të fushës së sigurisë.

Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë (e Kosovës)⁴, Ligji Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror dhe Ligji Nr. 04/L-214 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/I-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror janë aktet kryesore juridike mbi bazën e të cilave Policia e Kosovës (PK), operon në aspektin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Qeveria e Kosovës i ka nënshkruar rreth 98 marrëveshje

² Po aty, f. 88.

³ (Kursani, 2015, fq. 6-7).

⁴ Neni 44, Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë.

ndërkombëtare me vendet e tjera.⁵ Prej tyre vetëm gjashtë numërohen në fushën e bashkëpunimit policor, si ajo me Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Belgjikën dhe Turqinë. PK-ja ndërkaq ka arritur marrëveshje bilaterale me afro 18 shtete të ndryshme. Ndërsa, 58 marrëveshje numërohen të ketë arritur me policitë e këtyre vendeve për koordinim dhe këmbim të informacioneve për raste të ndryshme kriminale.⁶

Vitet 2012-2014 ka qenë periudha mbase më e frytshme për Kosovën sa i përket anëtarësimit në organizatat rajonale të sigurisë. Më 2013 Kosova u bë pjesë e Këshillit për Bashkëpunimin Rajonal (KBR). Ndërsa, aktualisht numëron pjesëmarrjen e saj edhe në njëmbëdhjetë nisma apo organizata rajonale të sigurisë dhe mbrojtjes, duke përfshirë SEECIP-në, Qendrën për Bashkëpunim në fushën e Sigurisë (RACVIAC), Njësinë për Koordinim Ndërkombëtar për Zbatim të Ligjit (ILECU), Qendrën Trajnuese për Përkrahjen e Operacioneve Paqësore (PSOTC), Konventën e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore (PCCSEE), Rrjetin e Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor (WBPN), Asociacionin e Shefave të Policisë në Evropën Juglindore (SECPA), Nismën Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI), Qendrën për Zbatim të Ligjit në Evropën Juglindore (SELEC), Grupin për Këshillime të Prokurorëve në Evropën Juglindore (SEEPAG) si dhe Kontrollin e Armëve të Vogla në Evropën Juglindore (SEESAC).

Kosova ka bashkëpunim edhe me SEDM-në përmes SEESAC-ut dhe RACVIAC-ut. Me Forumin e Ballkanit Perëndimor për Mbrojtje (SEEC) numëron bashkëpunim vetëm përmes KBR-së. Megjithatë, ende ka paqartësi rreth statusit të Kosovës në disa prej këtyre organizatave. Kjo, sipas disa zyrtarëve shtetërorë të Kosovës, duket të jetë kështu edhe për shkak të paraqitjes së Kosovës me fusnotën që përmban Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit (KS) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).⁷

Në maj të vitit 2016, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) e Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen me Agjencinë Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian (FRONTEX) për vendosjen e bashkëpunimit operacional në mes të MPB-së me FRONTEX-in.⁸ Kosova figuron si "asistuese"⁹ për kthimin e emigrantëve nga shtetet e zonës Schengen në FRONTEX.¹⁰ Marrëveshja me FRONTEX-in, e cila është agjenci në kuadër të Bashkimit Evropian (BE), do t'i mundësojë Kosovës të bashkëpunojë me këtë agjenci në fusha të

5 Shih listën e marrëveshjeve të nënshkruara nga Qeveria e Kosovës me vendet e tjera: [http://www.mei-ks.net/repository/docs/Aneksi_D - Lista e Marreveshjeve Nderkombetare te Qeverise se Kosoves%5B1%5D.pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/Aneksi_D_-_Lista_e_Marreveshjeve_Nderkombetare_te_Qeverise_se_Kosoves%5B1%5D.pdf). Qasur më 12 tetor 2016.

6 Intervistë me një zyrtar të lartë të Policisë së Kosovës.

7 Intervistë, Nuredin Ibishi, Anëtar i Komisionit parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 21 qershor 2016.

8 (Koha Net, 2016b).

9 Shih rolin e Kosovës në FRONTEX: <http://frontex.europa.eu/search-results?q=kosovo>. Qasur më 24 shtator 2016.

10 Po aty.

ndryshme, përfshirë shkëmbimin e informacioneve dhe operacionet e përbashkëta. Ndërsa, Departamenti i Kufirit i PK-së do të luaj një rol të rëndësishëm për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.¹¹ Pavarësisht arritjes së kësaj marrëveshjeje, megjithatë vetëm shtetet që janë nënshkruese të marrëveshjes së Zonës Shengen si dhe dy përfaqësues të Komisionit Evropian mund të jenë anëtarë të Bordit Menaxhues të kësaj agjencie, të cilët kanë të drejtë vote si anëtarë me të drejta të plota. Shtetet apo përfaqësuesit tjerë në këtë agjenci gëzojnë të drejta të kufizuara sa i përket të drejtës për të votuar në procesin e vendimmarrjes së FRONTEX-it.¹²

Sa i përket Nismës Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI), Kosova është anëtarësuar në qershor të vitit 2015, duke u bazuar në Deklaratën e Shkupit të Forumit të MARRI-t. Sipas kësaj të fundit, Kosova i gëzon të gjitha të drejtat e barabarta si shtetet tjera anëtare (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia dhe Serbia) në MARRI.¹³ Megjithatë, marrëveshja e arritur mes Kosovës dhe MARRI-t akoma pret ratifikimin nga Kuvendi i Kosovës.¹⁴ Neglizhenca e deritashme tregon se nuk ka vullnet serioz për të zyrtarizuar dhe avancuar pjesëmarrjen e Kosovës në nisma me rëndësi për çështje të sigurisë në Kosovë, përkundër diskursit politik të institucioneve kosovare për përfaqësim dhe anëtarësim të vendit në nismat rajonale të sigurisë.

RACVIAC-u është pasuesi i ligjshëm i Qendrës për Asistim në Zbatim dhe Verifikim të Kontrollit Rajonal të Armëve. Në tetor të vitit 2014, Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) e Kosovës e kishte proklamuar po ashtu anëtarësimin Kosovës në RACVIAC si e barabartë në aktivitetet e organizatës dhe në mënyrë të përhershme. Megjithatë, Kosova nuk figuron si anëtare në asnjërin nga këto tri kategori të shteteve anëtare të kësaj organizate: (1) shtetet anëtare të SEECP-së; (2) shtetet e asociuara; apo (3) shtetet e tjera, ku hyjnë institucionet ose organizatat, të cilat marrin pjesë në aktivitetet e RACVIAC-ut si vëzhguese.¹⁵ Edhe pse Kosova e ka përfaqësuesin e saj në RACVIAC, institucionet e saja nuk kanë ndërmarrë asnjë hap konkret për anëtarësim në këto kategori të shteteve anëtare të RACVIAC-ut. Në vitin 2013 Kosova kishte bërë kërkesë për anëtarësim në RACVIAC, por ajo ishte refuzuar me argumentin se Kosova nuk ishte asokohe pjesë e SEECP-së. Pavarësisht se vendi u anëtarësuar në SEECP në vitin 2014, ekzekutivi kosovar nuk e shfrytëzoi këtë anëtarësim si argument për të avancuar pjesëmarrjen e Kosovës në RACVIAC.

Në përgjithësi, shihet se Qeveria e Kosovës nuk ka bërë lëvizje konkrete për të avancuar pozicionin e Kosovës në nismat apo organizatat ku aktualisht ka përfshirje qoftë si e "asociuar" që nënkupton pa të drejtën e votës apo si vëzhguese. Megjithëse ka arritur

11 (FRONTEX, 2016).

12 Shih organizimin e brendshëm të FRONTEX-it: <http://frontex.europa.eu/about-frontex/organisation/management-board/>. Qasur më 24 shtator 2016.

13 Përgjigje me shkrim nga zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Valdet Hoxha, 12 tetor 2016.

14 Po aty.

15 (Emini, 2014, fq. 16-17).

marrëveshje bilaterale me disa shtete njohëse, sfidat më të mëdha Kosova vazhdon t'i ketë në bashkëpunimin bilateral me Serbinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën. Me të dyja këto shtete Kosova ka mungesë të madhe të shkëmbimit të çfarëdolloj informacioni, përfshirë fushën e sigurisë.¹⁶ Rrjedhimisht, Kosova jo pak herë është vënë në rrezik. Në fund të vitit 2014, një shtetas serb kishte hyrë në Kosovë nga Serbia me afro 12 kilogram eksplozivë, të cilat i ishin gjetur kur ishte arrestuar nga PK-ja në Prishtinë.¹⁷ Ai ishte shpallur fajtor për terrorizëm nga gjykata, e cila konstatoi se destinacioni i tij ishte "Grand Hotel" në Prishtinë, që gjendet në qendër të kryeqytetit kosovar.¹⁸ Ky rast ishte konsideruar nga autoritetet kosovare si dështim i parandalimit të krimit, si pasojë e pamundësisë së institucioneve kosovare për të shkëmbyer informacione me Serbinë dhe mosbashkëpunimit institucionet serbe me ato të Kosovës në fushën policore.

Komunikimin mes Kosovës dhe Serbisë në fushën policore e lehtëson misioni i OKB-së në Kosovë (UNMIK), përmes takimeve që mbahen mes policive të dy shteteve në Kurshumli të Serbisë, çdo 8-12 javë apo varësisht prej rasteve, gjegjësisht informacioneve që pranon UNMIK-u. Por, deri më tani në këto takime kryesisht janë këmbyer informata në lidhje me prerjet ilegale të pyjeve, por jo edhe për raste të krimeve të rënda.¹⁹ Pasojat e mosbashkëpunimit të mirëfilltë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në fushën e sigurisë u shfaqën gjatë viteve 2014 dhe 2015 kur shumë qytetarë të Kosovës, përmes rrugëve ilegale të Serbisë, emigruan drejt vendeve të BE-së për të kërkuar azil (kryesisht në Hungari, Gjermani dhe vende të tjera të BE-së).²⁰

Pengesat politike nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina, mos-njohja e pavarësisë së Kosovës nga pesë shtetet anëtare të BE-së (Greqia, Qiproja, Rumania, Spanja dhe Sllovakia) dhe nga ato të OKB-së janë duke e vështirësuar edhe më shumë procesin e anëtarësimit të Kosovës në nismat rajonale, duke përfshirë ato të sigurisë. Sidoqoftë, pas arritjes së Marrëveshjes së Brukselit²¹ në mes të Kosovës e Serbisë për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal, emrit zyrtar të Kosovës në nismat rajonale i vihet fusnota (Kosova*). Kjo marrëveshje ka vënë në dilemë statusin e Kosovës karshi atyre nismave rajonale ku është e pranishme edhe Serbia.

16 (Radio Evropa e Lirë, 2016a).

17 Intervistë, Nuredin Ibishi, Anëtar i Komisionit parlamentar për Punët të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 21 qershor 2016.

18 (Koha Net, 2016c).

19 Intervistë, Carsten Twelmeier, Këshilltar i lartë për polici në UNMIK, 31 mars 2016.

20 (Telegrafi, 2015).

21 Shih Marrëveshjen e Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Konkluzionet_0210_arranzhime.pdf. Qasur më 11 tetor 2016.

1.2. Zbatimi i Marrëveshjes së Brukselit për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal

Kjo marrëveshje ishte konsideruar nga Qeveria kosovare si sukses për të mos penguar Serbia rrugën e anëtarësimit të Kosovës në nismat rajonale. Megjithatë, sukcesi i vetëm i arritur konsiderohet fakti se Serbia nuk po braktis sallat e takimit ku është e pranishme edhe Kosova, në takimet rajonale ku Kosova përfaqësohet me fusnotë.²² Autoritetet ndërkombëtare në Bruksel kanë dështuar ta parashikojnë me Marrëveshjen e Brukselit rolin e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe ndikimit të Serbisë në të. Për më tepër, Bosnja dhe Hercegovina po vazhdon të paraqes bllokada për Kosovën në procesin e anëtarësimit në organizatat e sigurisë të nivelit rajonal duke e ditur që një numër i madh i nismave rajonale të sigurisë selitë kryesore i kanë në Bosnjë.²³

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se përkundër kauzës së nënshkrimit të saj, Marrëveshja e Brukselit për bashkëpunim rajonal mes Kosovës dhe Serbisë ka vështirësuar anëtarësimin e Kosovës në nisma rajonale, por edhe në ato ndërkombëtare. Për më tepër, kjo marrëveshje po konsiderohet nga disa zyrtarë shtetërorë, si e “keqja më e madhe e Kosovës” në vitet pas shpalljes së pavarësisë në aspektin politik.²⁴ Kjo për faktin se me pëlqim të palës kosovare i vihet një fusnotë emrit zyrtar të Kosovës, ku emërtimi “Republika e Kosovës” bëhet “Kosova*”, me fusnotën që përmbledh konstatimin se: *“Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244²⁵ dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës”*.²⁶ Marrëveshja thotë qartazi se sa i përket përfaqësimit rajonal duhet të shmanget përdorimi i simboleve shtetërore: *“Nikoqiri i takimeve do të inkurajohet që të shmang shpërfaqjen e simboleve shtetërore përveç të tij dhe të BE-së, duke marrë për bazë statutet e organizatave relevante”*.²⁷ Megjithatë, me këtë marrëveshje nuk është qartësuar nëse pjesëmarrja e Kosovës në nismat rajonale është si anëtare me të drejta të plota apo vetëm si pjesëmarrëse në këto nisma. Për më tepër, Marrëveshja e Brukselit pritej të sillte një dinamikë të re të bashkëpunimit rajonal dhe t’ia hapte dyert Kosovës që të bëhej pjesë e nismave rajonale të sigurisë, të grupeve punuese si dhe të strukturave të tjera që janë ndërtuar gjatë dekadave të fundit me qëllim që të rritet bashkëpunimi

22 Intervistë me një zyrtar të lartë të Qeverisë së Kosovës.

23 Intervistë, Nuredin Ibishi, Anëtar i Komisionit parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 21 qershor 2016.

24 Po aty.

25 Rezoluta 1244 e KS të OKB-së u miratua më 10 qershor 1999 pas marrëveshjes për tërheqjen e trupave serbe nga Kosova. Ky dokument përcakton statusin politik të Kosovës si protektorat nën administrimin e OKB-së. Derisa kjo e fundit është përgjegjëse për administratën civile, NATO-ja ka mandat në fushën e sigurisë në Kosovë.

26 Shih Marrëveshjen e Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Konkluzionet_0210_arranzhime.pdf. Qasur më 11 tetor 2016.

27 Po aty.

ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor.²⁸ Madje, kjo pritej të lëkundte qëndrimin e pesë shteteve mos-njohëse të BE-së karshi Kosovës,²⁹ gjë që deri më tash (nëntor 2016) ende nuk ka ndodhur.

Megjithatë, disa lëvizje pozitive janë vërejtur si rezultat i kësaj marrëveshjeje. Që nga arritja e saj në vitin 2012 mund të konstatohet se është rritur prania e institucioneve të Kosovës në nismat rajonale, ndërsa është zvogëluar roli dhe prania e UNMIK-ut. Por, efektet e kësaj marrëveshjeje nuk mund të shihen përtej fokusit të saj rajonal, e as sa i përket anëtarësimit të Kosovës në nisma rajonale.³⁰ Kjo marrëveshje konsiderohet se ia solli Kosovës disa përfitime, siç është anëtarësimi i saj në KBR në tetor të vitit 2013, e cila është organizatë rajonale që përbëhet prej 46 shteteve, organizatave të ndryshme dhe institucioneve ndërkombëtare financiare. Por, përkundër pritjeve të arsyeshme, anëtarësimi nuk rezultoi në përfshirjen aktive të Kosovës në rrjetin dhe projektet e KBR-së.³¹ Kosova nuk është akoma pjesë e 14 nismave që janë pjesë e KBR-së. Në anën tjetër, sipas disa zyrtarëve shtetëror të Kosovës, shtetet mos-njohëse të Kosovës, si Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina (për shkak të ndikimit serb mbi çështjet e brendshme politike të Bosnjës dhe Hercegovinës), lehtësisht mund ta përdorin këtë fusnotë për të bllokuar pjesëmarrjen dhe anëtarësimin e Kosovës në nismat rajonale të sigurisë.³² Marrëveshja e Brukselit mendohej se do të përfundojë me procesin e anëtarësimit të Kosovës në OKB. Por, në mungesë të strategjisë së diplomacisë kosovare për anëtarësim në OKB, Qeveria e vendit u kritikua se e ka betonuar Rezolutën 1244 të KS të OKB-së.³³ Rrjedhimisht, për shtetet që e kanë njohur Kosovën, anëtarësimi dhe pjesëmarrja e Kosovës në nismat rajonale nënkupton pjesëmarrje dhe anëtarësim të një shteti të pavarur. Për shtetet që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, pjesëmarrja dhe anëtarësimi i saj paraqet një subjekt të pavarur të së drejtës ndërkombëtare me kapacitet të barabartë me shtetet tjera për të marrë të drejta dhe obligime ndërkombëtare, por me status të padefinuar politik. Në pikëpamje juridike, statusi i Kosovës në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare përcaktohet e rregullohet me rregullat e brendshme të organizatës (statutit apo dokumentit themeltar) në të cilat Kosova paraqet kërkesë për anëtarësim. Në rastet kur organizatat janë të hapura vetëm për shtete dhe Kosova anëtarësohet në to, atëherë i bie që Kosova është e anëtarësuar si shtet pavarësisht fusnotës dhe Rezolutës 1244. Në rast se organizatat janë të hapura vetëm për entitete, atëherë duhet të shikohet se me çfarë statusi ka

28 (Koha Net, 2015b).

29 (Emini, 2014, f. 12).

30 Intervistë, Kushtrim Istrefi, njohës i së drejtës ndërkombëtare, 18 gusht 2016.

31 (Emini, 2014, f. 13).

32 Intervistë, Nuredin Ibishi, Anëtar i Komisionit parlamentar për Punët e Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 21 qershor 2016.

33 (Koha Net, 2015b).

aplikuar dhe është pranuar Kosova³⁴, megjithëse nismat dhe organizatat rajonale i atribuohen kryesisht shteteve.

Një nismë tjetër me rëndësi për Kosovën që të anëtarësohet është Karta e Adriatikut (AC). Edhe këtu ka pasur pengesa të vazhdueshme politike nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Ndikimi i këtyre vendeve është dëshmuar edhe në rastin e SEDM-it, ku Kosova kishte kërkuar statusin e vëzhguesit. Megjithatë, Serbia dhe Rumania kanë dal kundër, duke e bërë të pamundur arritjen e konsensusit që Kosova të anëtarësohet.³⁵ Ndikimi i shteteve mos-njohëse ka bërë që përfaqësuesit e Kosovës të braktisin konferencën ministrore të Procesit të Pragës (PP) rreth krizës me emigrantë, që ishte mbajtur në shtator të vitit 2016 në Sllovaki. Kjo ndodhi si pasojë e mos-përfaqësimit të Kosovës me simbole shtetërore në PP, por vetëm me fusnotë.³⁶ Në të vërtetë, një veprim i tillë nga ana e zyrtarëve shtetërorë të Kosovës mund të konsiderohet edhe i çuditshëm, meqë vënia e fusnotës në emrin zyrtar të Kosovës, si pasojë e së cilës po lëshohen sallat e takimeve, ishte pranuar nga vetë zyrtarët e Qeverisë së Kosovës, të cilët nënshkruan Marrëveshjen e Brukselit në emër të bashkëpunimit rajonal mes Kosovës dhe Serbisë.

Sfidë për Kosovën si pasojë e pengesave politike konsiderohet në veçanti procesi i anëtarësimit në organizatat, si Njësia e BE-së për Bashkëpunim Gjyqësor (EUROJUST), Agjencia e BE-së për Zbatim të Ligjit (EUROPOL) dhe Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale (INTERPOL). Në të dy këto të parat (EUROJUST dhe EUROPOL) Kosova nuk mund të anëtarësohet derisa të anëtarësohet me të drejta të plota si shtet anëtar i BE-së. Megjithatë, kjo nuk nënkupton që nuk mund të arrihen marrëveshje strategjike me të dyja këto organizata me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit trans-nacional, veçanërisht në kohën kur shtetet e Evropës po përballen me kërcënime nga ekstremizmi i dhunshëm. Për këtë Qeveria e Kosovës duhet të ketë strategji të mirëfilltë lobimi. Ndërsa, procesi i vështirë i anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL analizohet në pjesën e dytë të këtij hulumtimi.

34 Intervistë, Kushtrim Istrefi, njohës i së drejtës ndërkombëtare, 18 gusht 2016.

35 (Emini, 2014, f. 15).

36 (Koha Net, 2016d).

PJESA 2 – RASTI I INTERPOL-it

Bazat fillestare të INTERPOL-it ishin hedhur në vitin 1914 kur ishte mbajtur Kongresi Ndërkombëtar i Policisë Kriminale në Monako. Ndonëse, zyrtarisht ishte themeluar në vitin 1923, kjo organizatë tek në vitin 1956 do të merrte emërtimin që e ka edhe sot – INTERPOL.³⁷ Kjo është organizata më e madhe ndërkombëtare për bashkëpunim policor në të cilën janë të anëtarësuar 190 vende.³⁸

Qëllimi i INTERPOL-it është të ofrojë mbështetje sa më të madhe për institucionet policore të vendeve që janë anëtare të INTERPOL-it në pajtim me ligjet e vendeve përkatëse dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu, ky mekanizëm ndërkombëtar i bashkëpunimit policor ka për synim zhvillimin e institucioneve për të parandaluar dhe luftuar në mënyrë efektive veprat penale të shkaktuara nga shkelësit e ligjit.³⁹

INTERPOL-i ka katër prioritete strategjike që rrjedhin si rezultat i sfidave të bashkëpunimit ndërkombëtar policor në shekullin XXI. Ato përfshijnë: (1) sigurimi i një sistemi të informacionit global policor; (2) mbështetja e vazhdueshme (24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë) për institucionet policore të vendeve anëtare në zbatimin e ligjit; (3) ndërtimi i kapaciteteve përmes mbështetjes dhe trajnimeve të ndryshme në fushën e zbatimit të ligjit; si dhe (4) mbështetja në identifikimin e krimeve dhe kriminelëve përmes informacioneve të bazës së të dhënave të INTERPOL-it.⁴⁰

Për realizimin e këtyre qëllimeve dhe aktiviteteve tjera që ndërlidhen me këtë organizatë, në çdo vend anëtar të INTERPOL-it është e vendosur Byroja Kombëtare Qendrore (BKQ). BKQ-të shërbejnë si urë lidhëse ndërmjet policive të vendeve anëtare dhe rrjetit global të INTERPOL-it.⁴¹ Nga ana tjetër, INTERPOL-i i ka edhe organet e veta drejtuese, siç janë Asambleja e Përgjithshme, Komiteti Ekzekutiv dhe Sekretariati i Përgjithshëm.

INTERPOL-i në bashkëpunim me vendet anëtare punon në parandalimin dhe hetimin e krimeve të llojeve të ndryshme.⁴² Në këtë mënyrë, bashkëpunimi policor ndërkombëtar

37 Shih: <http://www.interpol.int/About-INTERPOL/History>. Qasur më 25 korrik 2016.

38 Shih listën e shteteve që janë anëtare të INTERPOL-it: <http://www.interpol.int/Member-countries/World>. Qasur më 25 korrik 2016.

39 Article 2, Constitution of the ICPO-INTERPOL [I/CONS/GA/1956(2008)].

40 Shih: <http://www.interpol.int/About-INTERPOL/Priorities>. Qasur më 26 korrik 2016.

41 Fact Sheet – INTERPOL: an overview, COM/FS/2015-02/GI-01, f. 1.

42 Shih: <http://www.interpol.int/Crime-areas>. Qasur më 27 korrik 2016.

shtrihet në luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit, trafikimit me qenie njerëzore e terrorizmit, por që nuk kufizohet vetëm në luftimin e këtyre fenomeneve.⁴³

Është e rëndësishme të përmendet se për t'u anëtarësuar në INTERPOL nuk është kusht ose kriter që paraprakisht të jesh vend anëtar i OKB-së.⁴⁴ Vende të cilat nuk janë anëtare të kësaj të fundit janë anëtarësuar në INTERPOL me të drejta të barabarta krahas vendeve të tjera. Si rrjedhojë, për rastin e anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL nuk do të jetë sfidë mos-anëtarësimi i saj në OKB. Sidoqoftë, ekzistojnë pengesa të tjera politike që do ta vështirësojnë rrugën e anëtarësimit të Kosovës drejt INTERPOL-it.

2.1. Marrëdhëniet e Kosovës me INTERPOL-in përmes UNMIK-ut

Institucionet e Kosovës nuk kanë ende marrëdhënie apo bashkëpunim zyrtar me INTERPOL-in. Kjo për shkak se Kosova nuk është anëtare e kësaj organizate dhe atë për dy arsye. Në njërin anë, institucionet kosovare e kanë vënë si prioritet përafrimin dhe anëtarësimin në INTERPOL vetëm viteve të fundit duke mos dëshmuar seriozitet të dukshëm në raport me vendosjen e bashkëpunimit ndërkombëtar policor me INTERPOL-in. Ndërsa, në anën tjetër, pengesat politike ku një pjesë e konsiderueshme e vendeve që janë anëtare të INTERPOL-it nuk e kanë njohur pavarësinë e shtetit të Kosovës ka ndikuar gjithashtu të zvarritet edhe më tej vendosja e marrëdhënieve zyrtare në mes të Kosovës dhe INTERPOL-it. Në këtë drejtim, prania e UNMIK-ut në Kosovë dhe mbetja në fuqi e Rezolutës 1244 të KS të OKB-së ka sjell pengesa të mëdha në përafrimin e Kosovës me INTERPOL-in. Prandaj, kontakti i vetëm i institucioneve të Kosovës me INTERPOL-in edhe më tutje zhvillohet përmes kanaleve të misionit të UNMIK-ut, që në të vërtetë është kontakt i tërthortë ku institucionet kosovare nuk janë palë zyrtare.

Në këtë mënyrë, gjatë kohës sa Kosova ishte nën administrimin ndërkombëtar, përkatësisht në vitin 2002 ishte nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet përfaqësuesve të INTERPOL-it dhe UNMIK-ut. Ky memorandum ishte lidhur me qëllim të bashkëpunimit në mes të të dyja palëve në fushën e parandalimit të krimit dhe të drejtësisë penale, duke përfshirë shkëmbimin e informacioneve të policisë së atëhershme të UNMIK-ut me INTERPOL-in, publikimin dhe qarkullimin e fletarrestimeve, si dhe qasjen e UNMIK-ut në rrjetin telekomunikues dhe në bazën e të dhënave të

43 Po aty.

44 Shih listën e shteteve anëtare të OKB-së: <http://www.un.org/en/member-states/index.html>. Qasur më 8 shtator 2016.

INTERPOL-it.⁴⁵ Ky memorandum mirëkuptimi është ende në fuqi për zbatimin e të cilit në Kosovë përgjegjës është misioni i UNMIK-ut.

Në kuadër të misionit të UNMIK-ut është Zyra Ndërlidhëse për Sundimin e Ligjit nën të cilin funksionon Njësia Ndërlidhëse UNMIK-INTERPOL, e cila është përgjegjëse për të lehtësuar procesin e lëshimit të fletarrestimeve përmes INTERPOL-it për personat e kërkuar ndërkombëtarisht.⁴⁶ Përveç kësaj, përgjegjësitë e UNMIK-ut në këtë rrafsh përfshijnë edhe lehtësimin e bashkëpunimit të PK-së me INTERPOL-in.⁴⁷ Kjo nënkupton se institucionet përkatëse të Kosovës nuk kanë kontakt të drejtpërdrejtë me INTERPOL-in dhe, për më tepër, sipas rrethanave ekzistuese, nuk mund ta shmangin kanalin e komunikimit me UNMIK-un sa i përket bashkëpunimit me INTERPOL-in.

Duke e ditur se UNMIK-u i ka përgjegjësitë e plota për të koordinuar aktivitetet me INTERPOL-in sa i përket Kosovës, atëherë ky mision ndërkombëtar bashkëpunon ngushtë me PK-në, përkatësisht me Njësinë për Koordinim Ndërkombëtar për Zbatim të Ligjit (ILECU), e cila funksionon në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme të PK-së.⁴⁸ UNMIK-u ndan me ILECU-n informata, porosi dhe të dhëna të cilat i merr nga INTERPOL-i për Kosovën. Për më tepër, përfaqësues të UNMIK-ut kanë konstatuar se çfarëdo informatash që kanë për të ndarë me PK-në i ndajnë në mënyrë të shpejt duke i ofruar informata ILECU-t.⁴⁹ Megjithatë, institucionet e Kosovës nuk e kanë ndarë të njëjtin qëndrim, me arsyetimin se Njësia Ndërlidhëse UNMIK-INTERPOL është joefektive dhe shumë e ngadalshme në ndarjen e informatave me institucionet kosovare.⁵⁰ Kritikta ndaj UNMIK-ut nga ana e Qeverisë së Kosovës kanë të bëjnë me atë se edhe në rastet kur UNMIK-u i shkëmben informatat tek ILECU-u këtë e bën duke i rezervuar vetes "privilegjin" se cilat informatat t'i shkëmbejë me PK-në dhe cilat informata t'i ruaj për vete.⁵¹ Tendencat e institucioneve të Kosovës, përfshirë ILECU-n është të pakësojë sa më shumë kontaktin me misionin UNMIK në Kosovës sa i përket bashkëpunimit në fushën e INTERPOL-it. Kjo për shkak se zyra e INTERPOL-it në kuadër të UNMIK-ut nuk i ndan dhe shkëmben informacionet e plota me institucionet kosovare, derisa ka raste kur UNMIK-u nuk i ndan fare informacionet me PK-në ose institucionet tjera vendore.⁵²

45 Article 1, Memorandum of Understanding between the International Criminal Police Organization-INTERPOL and the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo on Co-operation in Crime Prevention and Criminal Justice.

46 Intervistë me një zyrtar të lartë të UNMIK-ut, 17 qershor 2016.

47 Shih: <http://www.unmikonline.org/Pages/rollo.aspx>. Qasur më 27 korrik 2016.

48 (Government of the Republic of Kosovo, 2011, f. 2).

49 Intervistë me një zyrtar të lartë të UNMIK-ut, 17 qershor 2016.

50 Intervistë, Shqipe Mjekiqi, Këshilltare e lartë politike e ministrit të Punëve të Brendshme, 14 qershor 2016.

51 Po aty.

52 Intervistë me një zyrtar të lartë të Qeverisë së Kosovës, 20 shtator 2016.

Ndërkaq, siç dihet mirëfilli, dekadave të fundit grupet e krimit të organizuar janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe krimet e tyre i tejkalojnë kufijtë gjeografikë të shteteve duke marrë kështu karakter trans-nacional.⁵³ Derisa parandalimi dhe luftimi i aktiviteteve kriminale me dimension trans-nacional është pothuajse i pamundur të luftohet vetëm nga një shtet, atëherë ka lindur nevoja e bashkëpunimit ndërkombëtar të shteteve me INTERPOL-in. Prandaj, anëtarësimi i Kosovës në INTERPOL do t'i mundësonte PK-së ndarjen dhe shkëmbimin e ndërsjellë të informacioneve me INTERPOL-in (dhe me shtetet anëtare të kësaj të fundit) me qëllim të luftimit të kriminelëve dhe krimeve të ndryshme trans-nacionale brenda dhe jashtë territorit të Kosovës. Kjo, po ashtu, do të mundësonte bashkëpunimin e Kosovës me INTERPOL-in për të ndërmarrë operacione të përbashkëta për sundimin e ligjit.⁵⁴ Gjithashtu, nevojat dhe kërkesat e shumta të PK-së për të shkëmbyer informacione me INTERPOL-in dëshmojnë për rëndësinë që ka për të dyja palët anëtarësimi në këtë organizatë.⁵⁵ Pra, anëtarësimi i plotë i Kosovës në INTERPOL do të ndikonte në vendosjen dhe krijimin e komunikimit të drejtpërdrejtë të Kosovës me INTERPOL-in dhe me shtetet anëtare të kësaj organizate. Qasja e drejtpërdrejtë e institucioneve të Kosovës në sistemin e bazës së të dhënave të INTERPOL-it dhe prania e INTERPOL-it në kufijtë e Kosovës do të bënte të mundur që krimet trans-nacionale, të cilat ndodhin në Kosovë të luftohen në mënyrë proaktive.⁵⁶ Ndërkohë, grupet e krimit të organizuar dhe aktivitetet kriminale jo vetëm që do të luftoheshin në mënyrë me efikase, por edhe do të mund të parandaloheshin nga PK-ja dhe mekanizmat tjerë vendorë kur vendi të anëtarësohet në INTERPOL.

Krahas PK-së, një institucion tjetër me të cilin UNMIK-u ka bashkëpunim të rregullt është Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (DBJND) në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë (MD). Në raport me INTERPOL-in ky departament është i ngarkuar me detyra sa i përket procedurave të ekstradimit dhe fletëarresteve ndërkombëtare. Megjithatë, DBJND-ja në këtë aspekt nuk zhvillon kontakt të drejtpërdrejtë me UNMIK-un, por përmes Zyrës së Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovë (EUSR).⁵⁷ Pas grumbullimit të të gjithë materialit dhe informacionit nga autoritetet gjyqësore të Kosovës, DBJND-ja i dorëzon dokumentacionin EUSR-së, e cila nga ana tjetër ia përcjell po të njëjtin UNMIK-ut. Ndërsa, Njësia Ndërlidhëse UNMIK-INTERPOL e përcjell atë në Sekretariatit e Përgjithshëm të INTERPOL-it në Lyon të Francës. Ndërsa, kjo e fundit vendos për lëshimin e fletëarrestit ndërkombëtar apo jo.⁵⁸

53 (Kursani, 2015, f. 6).

54 (West, Founds, & Merja, 2015, f. 3).

55 Intervistë me një zyrtar të lartë të Qeverisë së Kosovës, 20 shtator 2016.

56 Po aty.

57 Intervistë, Arbër Gegaj, Udhëheqës i Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë, 14 korrik 2016.

58 Po aty.

Me përjashtim të PK-së, ky është komunikimi i tërthortë i institucioneve të Kosovës me organizatën e INTERPOL-it të cilin e zhvillon përmes pranisë së BE-së në Kosovë duke e shmangur kështu linjën e komunikimit të drejtpërdrejtë me UNMIK-un. Megjithatë vërehet se ekziston burokraci e madhe sa i përket komunikimit me INTERPOL-in. Kjo për shkak se duhet të kalohet nëpër dy nivele komunikimi: së pari institucionet kosovare përmes EUSR-së i dërgojnë informacione apo kërkesa UNMIK-ut dhe niveli i dytë i komunikimit kur UNMIK-u i dorëzon këtë dokumentacion në zyrat qendrore të INTERPOL-it. Edhe MD-ja ka kritikuar se ka vonesa të shumta për të dhënat që kërkojnë nga UNMIK-u.⁵⁹

Vështirësia për të komunikuar drejtpërdrejtë me INTERPOL-in dhe burokracia ekzistuese, ku për marrjen dhe dhënien e informacioneve duhet të kalohen disa kanale komunikimi, është duke e sfiduar Kosovën në luftimin e krimeve të ndryshme që i tejkalojnë kufijtë gjeografikë të vendit.⁶⁰ Dihet që shumë prej krimeve, si terrorizmi, krimi i organizuar, trafikimi me qenie njerëzore, kontrabanda me emigrantë dhe veprimtari të tjera kriminale, kanë marrë dimension ndërkombëtar duke e bërë të domosdoshme bashkëpunimin ndërmjet shteteve dhe mekanizmave ndërkombëtarë të bashkëpunimit policor për luftimin e këtyre krimeve. Në kontekstin e Kosovës, për pasojë, kjo ka shtruar nevojën e përafrimit dhe anëtarësimit në këto organizata ndërkombëtare të sigurisë, me theks të veçantë në INTERPOL. Bashkëpunimi aktual i institucioneve të Kosovës me INTERPOL-in përmes UNMIK-ut është i pamjaftueshëm duke e ngadalësuar dhe dëmtuar efikasitetin e institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë për luftimin e veprimtarive të ndryshme kriminale me karakter ndërkombëtar. Prandaj, anëtarësimi i Kosovës me të drejta të plota në INTERPOL është i një rëndësie të madhe për koordinimin e aktiviteteve në luftimin e krimeve të ndryshme trans-nacionale si dhe do të ndikonte në profesionalizimin e institucioneve kosovare, në veçanti të PK-së për të luftuar veprimtaritë kriminale ndërkufitare në bashkëpunim të ngushtë me INTERPOL-in dhe shtetet anëtare të kësaj organizate.

2.2. Procesi i anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL

Edhe pse procesi i anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL ka nisur dy vite pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, pra në vitin 2010, megjithatë bashkëpunimi ndërkombëtar policor nuk ka qenë në mesin e prioriteteve kryesore për institucionet e Kosovës. Për më tepër, prioritetet e politikës së jashtme të Kosovës ka qenë në vazhdimësi integrimi në BE dhe dialogu me Serbinë i lehtësuar nga BE-ja. Si pasojë e kësaj, përafrimi dhe anëtarësimi i Kosovës në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë, përfshirë

⁵⁹ Po aty.

⁶⁰ (West, Founds, & Merja, 2015, fq. 1-2).

INTERPOL-in ka mbetur nën hije të zhvillimeve të tjera politike. Derisa vëmendja është përqendruar kryesisht tek dialogu Kosovë-Serbi, megjithatë janë shterur mundësitë për t'u mbuluar vetëm çështjet e dialogut nga ana e politikës së jashtme të Kosovës duke e ditur që si proces ka nisur vite më parë dhe zbatimi i marrëveshjeve të dialogut është duke ngecur. Pavarësisht kësaj, diskursi politik në Kosovë sa i përket anëtarësimit në INTERPOL më shumë ka mbetur në nivelin deklarativ sesa që janë bërë vërtet përpjekje serioze në drejtim të vendosjes së bashkëpunimit zyrtar me mekanizmat ndërkombëtarë të bashkëpunimit policor. Për këtë arsye, qasja e diplomacisë kosovare duhet të ndryshojë dhe, në mesin e prioriteteve të tjera, të lëvizë përpara me agjendën për përgatitjen e vendit drejt anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare të sigurisë.⁶¹

Aplikacioni i parë për anëtarësim të Kosovës në INTERPOL ishte bërë në vitin 2010 nga krerët e MPB-së së Qeverisë së Kosovës të asaj kohe. Kërkesa për aplikim ishte dorëzuar tek Sekretari i Përgjithshëm i INTERPOL-it, por e cila nuk ishte kaluar tek organet tjera të INTERPOL-it për shqyrtim të mëtejshëm. Në të vërtetë, kishte pasur kontakte ndërmjet të dyja palëve ku INTERPOL-i kishte kërkuar nga ana e Kosovës plotësimin e një pyetësori, por që komunikimi ishte ndërprerë ndërkohë dhe nuk kishte vazhduar më tej.⁶² Ndërsa, kërkesa e dytë e institucioneve kosovare për anëtarësim në INTERPOL ishte bërë në muajin prill të vitit 2015. E nënshkruar nga kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, aplikacioni i dytë ishte dorëzuar në INTERPOL përmes kanaleve të tërthorta, gjegjësisht ishte përcjellë në INTERPOL nga misioni i UNMIK-ut.⁶³

Në parim, sipas dokumenteve në fuqi të INTERPOL-it, çdo vend mund të paraqes aplikacionin për anëtarësim në këtë mekanizëm ndërkombëtar. Kushtetuta e INTERPOL-it thotë se *“kërkesa për anëtarësim duhet të dorëzohet te Sekretari i Përgjithshëm nga autoritetet qeveritare”*⁶⁴ të vendit përkatës. Ndërsa, nuk përmendet nëse vendi përkatës kandidat duhet të plotësojë disa kushte apo jo lidhur kërkesën për anëtarësim në INTERPOL.

Pavarësisht kësaj, misioni i BE-së për sundim të ligjit në Kosovë (EULEX) ka hartuar një raport për gatishmërinë e PK-së për anëtarësim në INTERPOL. Vlerësimet e ekspertëve të EULEX-it kanë rekomanduar se PK-ja i plotëson kushtet teknike dhe operative për anëtarësim në INTERPOL. Në aspektin teknik thuhet se PK-ja është e përgatitur mirë të vendos lidhje të drejtpërdrejtë me rrjetin e INTERPOL-it për komunikim 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë si dhe të shkëmbejë të dhëna me INTERPOL-in. Në dokumentin e EULEX-it përmendet se vendosja e lidhjes së drejtpërdrejtë do t'i mundësojë PK-së të komunikojë me Sekretariatit e Përgjithshëm të INTERPOL-it dhe me të gjitha BKQ-të e kësaj organizate përmes sistemit të postës elektronike të INTERPOL-it. Ndërsa, rrjeti i

61 Për më tepër, shih skenarin e parë dhe të dytë të këtij raporti.

62 Intervistë, Shqipe Mjekiqi, Këshilltare e lartë politike e ministrit të Punëve të Brendshme, 14 qershor 2016.

63 Po aty.

64 Article 4, Constitution of the ICPO-INTERPOL [I/CONS/GA/1956(2008)].

Internetit në PK vlerësohet të jetë i mirë sa për të përmbushur standardin e INTERPOL-it sa i përket shfrytëzimit të Internetit në mënyrë të sigurt. Lidhur me standardet operative të zyrës së ILECU-ut të PK-së thuhet se ato janë në pajtim me parimet për mbrojtjen e të dhënave personale, trajtimin e të dhënave, sigurinë dhe shumicën e standardeve ndërkombëtare. Vërejtja e vetme për PK-në është zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të teknologjisë informative në kudër të sistemit informativ të policisë për t'ju përshtatur shërbimeve teknike të INTERPOL-it për këtë qëllim.⁶⁵

Derisa Kosova është e gatshme në aspektin teknik dhe operativ për anëtarësim në INTERPOL, sidoqoftë janë pengesat politike që e sfidojnë anëtarësimin e vendit në këtë organizatë ndërkombëtare të sigurisë. Pengesë kryesore e Kosovës për anëtarësim është mosnjohja e shtetësisë nga një pjesë e shteteve anëtare të OKB-së. Përkundër kësaj, institucionet e Kosovës nuk duhet të përsërisin gabimet si me rastin e dështimit për t'u anëtarësuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO). Në këtë rast, shtete të cilat madje kishin njohur pavarësinë e shtetit të Kosovës, nuk kishin votuar në favor të anëtarësimit të Kosovës në UNESCO.⁶⁶ Prandaj, institucionet përkatëse të Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me shtetet përkrahëse të saj, duhet të bashkërendojnë aktivitetet lobuese në mënyrë të kujdesshme që të bindin shtetet anëtare të INTERPOL-it për të arritur numrin e nevojshëm të votave për anëtarësim në këtë organizatë. Pavarësisht kësaj sfide, përparësi e Kosovës në këtë rast është se nuk i kërkohet anëtarësimi në OKB në rrugën e saj drejt anëtarësimit në INTERPOL. Në vijim të kësaj, vende si Hong Kongu e Makao ose qytet-shteti i Vatikanit, pa qenë fare vende anëtare të OKB-së, janë anëtarësuar në INTERPOL vite më parë. Kjo nënkupton se organizatat ndërkombëtare (si OKB-ja) nuk njohin shtete meqë kjo e drejtë u takon vetëm shteteve në mënyrë individuale, përkatësisht shtetet njohin shtete.⁶⁷ Ky argument juridik i kishte hapur rrugën Kosovës për t'u anëtarësuar në organizatat evropiane e ndërkombëtare të sportit, si në UEFA dhe FIFA, në maj të vitit 2016. Në këtë mënyrë, institucionet kosovare duhet të përgatiten për të shtuar njohjet e pavarësisë dhe të sigurojnë përkrahje sa më të gjerë për anëtarësim në INTERPOL.

Deri më tani (nëntor 2016) Kosova është njohur nga 112 shtete të OKB-së,⁶⁸ gjë që është e pamjaftueshme për anëtarësim në ato organizata ndërkombëtare, si INTERPOL-i, në të cilën janë të anëtarësuar 190 vende. Edhe pse Kosova është njohur nga shumica e vendeve të INTERPOL-it, megjithatë për anëtarësim në këtë organizatë nevojiten shumica prej 2/3 (dy të tretave) të votave të anëtarëve të shteteve të INTERPOL-it që janë të pranishëm në punimet e Asamblesë së Përgjithshme kur votohet për

65 Shih përmbledhjen e raportit vlerësues të EULEX-it për gatishmërinë e PK-së për anëtarësim në INTERPOL: "EULEX project to support Kosovo in their efforts to become an INTERPOL-Member", 18 March 2015, f. 2.

66 (Krasniqi, 2016, f. 2).

67 Shih interpretimin ligjor të drejtorit të Divizionit të Çështjeve Ligjore të UEFA-s, Alasdair Bell, gjatë punimeve të Kongresit të 40-të të UEFA-s në Budapest, lidhur me kërkesën e Kosovës për anëtarësim në UEFA. Qasur më 9 shtator 2016, në: <https://www.youtube.com/watch?v=5PODYbi9BPI>.

68 Shih listën e shteteve që kanë njohur pavarësinë e Kosovës: <http://www.kosovothanksyou.com/>. Qasur më 20 tetor 2016.

anëtarësimin e një shteti në INTERPOL.⁶⁹ Kjo nënkupton se, sipas procedurave juridike të INTERPOL-it, me rastin e votimit për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL, nuk është e obligueshme që në Asamblenë e Përgjithshme të jenë të pranishëm të gjitha shtetet anëtare të kësaj organizate. Në rastin tjetër, nëse në Asamblenë e Përgjithshme do të ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e shteteve prej 190 sosh kur do të votohej për kërkesën e Kosovës për anëtarësim, atëherë i bie që në favor të anëtarësimit të Kosovës do të duhej të votojnë të paktën 127 shtete, gjë që Kosova ende nuk i ka nëse krahasohet me numrin e njohjeve.

Shtetet që kanë njohur pavarësinë e Kosovës mbështesin qartazi anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL. Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA),⁷⁰ Britania e Madhe,⁷¹ Gjermania,⁷² Franca,⁷³ Austria⁷⁴ dhe shtetet tjera kanë arsyetuar në mënyra të ndryshme rëndësinë e anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare për bashkëpunim policor. Ato i kanë bërë thirrje Serbisë dhe vendeve hezituese që nuk e kanë njohur Kosovës të mos e bllokojnë rrugën e saj drejt INTERPOL-it me qëllim të lehtësimit të bashkëpunimit për zbatimin e ligjit sa i përket luftës kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar.⁷⁵ Për më tepër, diplomatë amerikanë kanë shprehur bindjen se UNMIK-u duhet të përkrah anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL dhe t'i bart përgjegjësitë e veta në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor tek Qeveria e Kosovës.⁷⁶ Nevoja për parandalimin dhe luftimin e krimeve që tejkalojnë kufijtë shtetërorë, sidomos lufta kundër terrorizmit kërkon bashkëpunim ndërkufitar dhe ndërkombëtar në mes të shteteve dhe organizatave ndërkombëtare për zbatimin e ligjit. Si rrjedhojë e kësaj, qeveritë e vendeve mbështetëse të Kosovës kanë vënë në dukje se për bashkëpunim të mirëfilltë për zbatimin e ligjit në mes të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor është më se e domosdoshme anëtarësimi i Kosovës në INTERPOL. Duke e konsideruar si thelbësore kontributin e Kosovës në INTERPOL, shtetet përkrahëse të kësaj të fundit kanë tërhequr vërejtjen se pengimi ose izolimi i Kosovës për t'u anëtarësuar në INTERPOL do të dëmtojë përpjekjet kolektive në luftimin e krimeve ndërkombëtare, derisa nga kjo do të mund të përfitonin vetëm kriminelët dhe ekstremistët.⁷⁷

Pa marr parasysh këtyre përpjekjeve, kërkesa e Kosovës për anëtarësim në këtë organizatë ka ngelur tek Sekretari i Përgjithshëm i INTERPOL-it dhe rrjedhimisht

69 Article 38(2,a), Rules of Procedure of the ICPO-INTERPOL General Assembly [II.A/RPGA/GA/1996(2004)].

70 (Koha Net, 2015a).

71 (United Nations, 2016b, f. 18).

72 (Koha Net, 2016a).

73 (Telegrafi, 2016).

74 (Ministria e Punëve të Jashtme, 2015).

75 (United Nations, 2015a, f. 17).

76 Po aty.

77 (United Nations, 2016b, f. 18).

nuk ka kaluar ende për shqyrtim në Komitetin Ekzekutiv të INTERPOL-it dhe as në Asambleshën e Përgjithshme të INTERPOL-it. Komiteti Ekzekutiv ka një përbërje të përzier të anëtarëve nga vende të ndryshme të botës që e kanë njohur pavarësinë dhe atyre që nuk e kanë njohur. Ky organ i INTERPOL-it përbëhet prej 13 anëtarëve gjithsej, por njëri nga anëtarët e Komitetit Ekzekutiv është tërhequr nga ky post dhe aktualisht (2016) ka mbetur me një anëtar më pak, gjegjësisht 12 anëtarë.⁷⁸ Prej 12 anëtarëve, 6 prej tyre vijnë nga shtetet që kanë njohur pavarësinë e Kosovës, ndërsa gjashtë anëtarë të tjera nga ato vende që nuk e kanë njohur Kosovën.⁷⁹ Në praktikë çdo shtet që aspiron të anëtarësohet në INTERPOL, përfshirë Kosovën duhet t'i sigurojë votat e shumicës prej 2/3 (dy të tretave) të anëtarëve të pranishëm të Asamblesës së Përgjithshme⁸⁰, e cila përbëhet gjithsejtë prej 190 anëtarëve. Megjithatë, para se të hyjë në agjendën e Asamblesës së Përgjithshme, kërkesa e Kosovës për anëtarësim në INTERPOL duhet të marrë fillimisht pëlqimin e shumicës së anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv. Kjo për shkak se Komiteti Ekzekutiv përgatit agjendën e mbledhjeve të Asamblesës së Përgjithshme,⁸¹ përfshirë këtu kërkesën e vendeve për anëtarësim në INTERPOL. Vlerësuar sipas rrethanave ekzistuese, ku Kosova e ka të vështirë të marrë shumicën e votave në Komitetin Ekzekutiv, rrjedhimisht shqyrtimit i rastit të Kosovës nuk pritet të kalojë në mbledhjen e Asamblesës së Përgjithshme të INTERPOL-it në vitin 2016. Ndërsa, as në vitin 2015 organet e INTERPOL-it nuk e kishin marrë në shqyrtim aplikacionin e Kosovës për anëtarësim në këtë organizatë.

Në të vërtetë, aplikacioni i Kosovës nuk pritet të shqyrtohet nga ana e INTERPOL-it para dy-tri viteve të ardhshme, jo vetëm për shkak të pengesave të përmendura më sipër, por edhe për shkak të kandidaturës së Palestinës që ka paraqitur aplikacionin për t'u pranuar në INTERPOL. Duke u nisur nga fakti që shumica e shteteve të cilat e kanë njohur Palestinën nuk e kanë njohur edhe pavarësinë e shtetit të Kosovës dhe anasjelltas, atëherë kjo e ka vështirësuar dhe ndërlikuar edhe më shumë pozicionin e Kosovës përballë anëtarësimit në këtë organizatë ndërkombëtare.⁸² Si pasojë e këtyre zhvillimeve, INTERPOL-i ka krijuar një grup të ekspertëve juridik e policor për të vlerësuar përmbushjen e kushteve të vendeve aplikuese (në këtë rast të Kosovës e Palestinës) për anëtarësim. INTERPOL-i pritet të dërgojë në intervale të ndryshme kohore misione vlerësimi në Kosovë për të shqyrtuar nëse Kosova është e gatshme për anëtarësim në INTERPOL.⁸³ Kjo do të shtyjë për një kohë edhe më të gjatë (mbase deri në vitin 2018 ose 2019) agjendën e anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë

78 Raportimi i ministrit të Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni, në Komisionin parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, 19 korrik 2016.

79 Shih përbërjen e Komitetit Ekzekutiv të INTERPOL-it për vitin 2016: <http://www.interpol.int/About-INTERPOL/Structure-and-governance/Executive-Committee>. Qasur më 29 gusht 2016.

80 Article 38(2,a), Rules of Procedure of the ICPO-INTERPOL General Assembly [II.A/RPGA/GA/1996(2004)].

81 Article 22, Constitution of the ICPO-INTERPOL [I/CONS/GA/1956(2008)].

82 (Qehaja, 2016).

83 (Radio Evropa e Lirë, 2016b).

policore dhe vendosjen e kësaj çështje në agjendën e Asamblesë së Përgjithshme të INTERPOL-it.

Sfidë në vetvete paraqet edhe Rezoluta 1244 e KS të OKB-së, e cila ende është në fuqi dhe e cila shfrytëzohet nga kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës në pretendimet e tyre kundër anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Pasi ndërmori fushatë të ashpër diplomatike duke i pamundësuar Kosovës të marrë votat e nevojshme për anëtarësim UNESCO,⁸⁴ Serbia e ka identifikuar procesin anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL si betejën e radhës diplomatike kundër anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare.⁸⁵ Madje, Serbia e kishte ngritur këtë çështje në mbledhjet e KS të OKB-së gjatë diskutimeve për Kosovën. Diplomatët serbë kanë ndarë pikëpamjen se anëtarësimi i Kosovës në INTERPOL është i “papranueshëm” për Serbinë meqë Kosova, sipas Rezolutës 1244, “është territor i administruar nga Kombet e Bashkuara”.⁸⁶ Sipas tyre, Kosova nuk mund të konsiderohet shtet sipas së drejtës ndërkombëtare, e me këtë as nuk ka të drejtë të anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare.⁸⁷ Edhe pse dihet roli i Serbisë kundër anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL dhe organizatat tjera ndërkombëtare, megjithatë Serbia do të mund të kushtëzohet nga shtetet përkras të Kosovës në BE që krahas përparimit në rrugën e saj drejt integritimit në BE të mos i pengojë synimet e Kosovës për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, përfshirë në këtë rast INTERPOL-in.

Përveç kësaj, edhe prania e Ruisë në Komitetin Ekzekutiv të INTERPOL-it është një pengesë tjetër kundërshtarëve të Kosovës në INTERPOL. Duke e ditur rolin e Ruisë në mbështetje të Serbisë për bllokimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare,⁸⁸ kjo është duke ia vështirësuar edhe më tepër Kosovës të sigurojë shumicën e votave në Komitetin Ekzekutiv për të kaluar më pas kjo në agjendën e Asamblesë së Përgjithshme të INTERPOL-it. Përkundër këtyre sfidave e pengesave politike, Kosova ka arritur të anëtarësohet në disa prej organizatave ndërkombëtare me rëndësi të madhe, si në Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë, Komitetin Olimpik Ndërkombëtar, UEFA e FIFA si dhe në mekanizma të tjerë rajonal e ndërkombëtar. Megjithatë, ngecja më e madhe në këtë drejtim ishte dështimi i institucioneve kosovare që u gjendën të papërgatitura për sa i përket anëtarësimit në UNESCO.

Pavarësisht se UNMIK-u e ka përcjellur në INTERPOL aplikacionin e Kosovës për anëtarësim përmes sistemit të vet elektronik, megjithatë marrëdhëniet ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe UNMIK-ut kanë vazhduar të jenë të padefinuara. Për më tepër, ministra të ekzekutivit kosovar kanë kritikuar misionin e OKB-së në Kosovë

84 (Krasniqi, 2016, f. 4).

85 (InSerbia Network Foundation, 2015).

86 (United Nations, 2015b, f. 5).

87 Po aty.

88 (Radio Evropa e Lirë, 2015).

si instrument të politikës rajonale të Rusisë për të bllokuar Kosovën në përfaqësimin ndërkombëtar. Madje, roli i UNMIK-u si mision ndërkombëtar është quajtur si “*zgjatje e ndikimit rus në Kosovë*” nga diplomacia kosovare.⁸⁹ Ndërsa, MPB-ja ka marrë vendim të mos marr pjesë në takimet e konferenca të nivelit ndërkombëtar përmes UNMIK-ut, duke refuzuar të përfaqësohet nga UNMIK-u qoftë edhe në takimet e thirrura nga INTERPOL-i.⁹⁰ Në këtë mënyrë, përfaqësues të kësaj ministrie, duke përfshirë edhe ata të PK-së, nuk pranojnë të marrin pjesë në çfarëdo takimi në të cilin ftohen së bashku me UNMIK-un jashtë vendit. Duke e ditur që UNMIK-u do të qëndrojë në Kosovë për sa kohë të jetë në fuqi Rezoluta 1244 e KS të OKB-së, shtetet përkrahëse të Kosovës megjithatë kanë kërkuar zvogëlim të mëtejshëm të stafit, mandatit dhe rolit të misionit UNMIK në Kosovë. Diplomatat e shteteve të përhershme të KS të OKB-së që kanë njohur pavarësinë e Kosovës (SHBA-të, Britania e Madhe dhe Franca) kanë konstatuar se situata në Kosovë ka përparuar dhe nuk ka nevojë të ngarkohet KS i OKB-së me raporte tremujore (për çdo vit) të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për situatën në Kosovë.⁹¹ Në vend të kësaj, këto shtete kanë sugjeruar që periudha raportuese në KS të OKB-së për Kosovën të jetë dy herë në vit ose çdo gjashtë muaj⁹² dhe, për më tepër, kanë kërkuar që përgjegjësitë të cilat i kanë mbetur UNMIK-ut barten gradualisht tek institucionet vendore të Kosovës.⁹³

Përveç këtyre pengesave kryesisht në rrafshin ndërkombëtar, prej vitit 2015 kur ishte bërë kërkesa e fundit për anëtarësim në INTERPOL është vërejtur se nuk ka koordinim ndërmjet institucioneve përkatëse të Kosovës për të lobuar lidhur me anëtarësimin në INTERPOL.⁹⁴ Që nga fillimi, ky proces është udhëhequr nga MPB-ja për shkak të natyrës së punës së kësaj organizate që i përket fushës së sigurisë, përkatësisht bashkëpunimit policor. Sidoqoftë, INTERPOL-i është para së gjithash organizatë ndërkombëtare dhe, rrjedhimisht, procesi i anëtarësimit në të do të duhej të udhëhiqej nga ana e MPJ-së për të mos krijuar konfuzion në lidhje me aktivitetet lobuese të anëtarësimit në INTERPOL.⁹⁵ Por, as bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy ministrive (MPB-së dhe MPJ-së) nuk ka treguar rezultate të prekshme. Kjo për shkak se koordinimi i aktiviteteve për anëtarësim në INTERPOL ka filluar shumë vonë, tek në muajin qershor të vitit 2016, shumë kohë pas aplikimit të Kosovës për anëtarësim në INTEPROL. Si pasojë, komunikimi dhe bashkëpunimi në mes të MPB-së dhe MPJ-së është vendosur me qëllim të sigurimit të përkrahjes së shteteve anëtare të INTERPOL-it për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë.⁹⁶ Në këtë drejtim, në gjysmën e dytë të vitit 2016 është

89 (Radio Televizioni Dukagjini, 2016).

90 Intervistë, Shqipe Mjekiçi, Këshilltare e lartë politike e ministrit të Punëve të Brendshme, 14 qershor 2016.

91 (United Nations, 2015a, f. 17).

92 (United Nations, 2016a, f. 19).

93 (United Nations, 2016b, f. 23).

94 (Radio Evropa e Lirë, 2016b).

95 (KTV – KohaVision, 2016b).

96 (Ministria e Punëve të Jashtme, 2016; Ministria e Punëve të Brendshme, 2016).

formuar një grup punues ndërmjet MPB-së, MPJ-së dhe ICITAP-it amerikan për të bashkërenduar veprimet ndërinstitucionale sa i përket anëtarësimit në INTERPOL. Nuk ka të dhëna për aktivitetet e deritashme (nëntor 2016) të këtij grupi punues në funksion të përgatitjeve për anëtarësim në INTERPOL. Sidoqoftë, bashkëpunimi ndërinstitucional ka ndodhur shumë vonë dhe ka ardhur në masë të madhe si pasojë e presionit të opinionit publik për lobim të mirëfilltë në këtë çështje për të evituar përsëritjen e gabimeve si me rastin e dështimit për t'u anëtarësuar në UNESCO.

2.3. Skenarët për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL

Në këtë hulumtim është analizuar se si procesi i anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL sfidohet nga pengesa të ndryshme. Rrjedhimisht, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka për qëllim të ofrojë opsionet në formën e politikave alternative (skenarëve) për të afruar Kosovën me organizatat rajonale e ndërkombëtare të sigurisë në përgjithësi dhe për të trasuar kështu rrugën e anëtarësimit të Kosovës me të drejta të plota në INTERPOL në veçanti. Skenarët, të cilët do të shqyrtohen në vijim, do të mund të shërbejnë si rekomandime për institucionet përkatëse të Kosovës me synim të avokimit për anëtarësimin e vendit në INTERPOL.

Sikurse sfidat e tjera të shtet-ndërtimit, edhe anëtarësimi në INTERPOL, të paktën deri më tash, ka dëshmuar pazotësinë e institucioneve të Kosovës për të udhëhequr në mënyrë serioze këtë proces. Kjo nënkupton se përveç pengesave të njohjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës nga një pjesë e konsiderueshme e shteteve anëtare të INTERPOL-it, edhe mosgatishmëria e institucioneve kosovare ka ndikuar në shtyrjen e procesit të anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare të bashkëpunimit policor. Por, pavarësisht pengesave politike, qoftë të brendshme e të jashtme, megjithatë Kosova, përkatësisht PK-ja është e gatshme teknikisht dhe profesionalisht për anëtarësim në INTERPOL.

Skenarët në vijim ofrojnë alternativat sa i përket anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL. Në këtë pjesë do të paraqitet rruga të cilën duhet ndjekur institucionet e Kosovës për anëtarësim në këtë organizatë ndërkombëtare.

2.3.1. Skenari i parë

Rruga e vështirë e Kosovës drejt anëtarësimit të plotë në INTERPOL kërkon angazhim serioz dhe konkret të institucioneve të Kosovës. Në këtë drejtim, MPJ-ja dhe MPB-ja e Kosovës duhet të bashkërendojnë të gjitha aktivitetet që do ta shpinin Kosovës për t'u anëtarësuar me të drejta të plota në INTERPOL.

Fillimisht duhet të ndryshohet qasja aktuale ku MPB-ja udhëheq me procesin e anëtarësimit në INTERPOL. Kjo nuk është në pajtim as me Analizën e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Kosovës në të cilën i është rekomanduar MPJ-së *“ndjekja e rrugës së anëtarësimit të plotë dhe aktiv në INTERPOL”*.⁹⁷ Duke e ditur që misioni i MPJ-së ndër të tjera është mbrojtja e interesave të Kosovës jashtë vendit dhe në organizatat ndërkombëtare,⁹⁸ atëherë anëtarësimi Kosovës në INTERPOL si proces duhet të udhëhiqet nga MPJ-ja. Ndërkohë, MPB-ja, PK-ja dhe mekanizmat tjerë vendorë do të mund të shërbejnë si bashkëpunëtorë të MPJ-së.

Kjo, padyshim, duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me MPB-në dhe atë në dy nivele: (i) përmes bashkëpunimit të brendshëm ndërmjet institucioneve të vendit; dhe (ii) përmes bashkëpunimit të diplomacisë kosovare me shteteve që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës për të lobuar rreth anëtarësimit në INTERPOL.

Me qëllim të intensifikimit të përpjekjeve për lobim sa i përket anëtarësimit në INTERPOL, institucionet e Kosovës, përfshirë MPJ-në, misionet diplomatike të Kosovës dhe MPB-në nuk duhet të veprojnë njëanshëm për këtë çështje. Çfarëdo aktiviteti lobues duhet të jetë i koordinuar ndërmjet akterëve që udhëheqin dhe bashkërendojnë proceset në raport me anëtarësimin e vendit në organizatat ndërkombëtare. Në këtë drejtim, grupi punues i krijuar në vitin 2016 ndërmjet përfaqësuesve të MPJ-së, MPB-së dhe ICITAP-it amerikan duhet të angazhohet drejtpërdrejtë për përgatitjen e vendit drejt anëtarësimit në INTERPOL përmes fushatave të ndryshme lobuese.

Ky grup punues duhet të bashkëpunojë ngushtë me ambasadat e Kosovës jashtë vendit për të shtrirë lobimin për agjendën e anëtarësimit në INTERPOL. Në të vërtetë, MPJ-ja duhet t'i kushtojë rëndësi të veçantë zyrtarëve ndërlidhës policorë ose atasheve policorë, pesë prej të cilëve tashmë janë të vendosur në disa ambasada të Kosovës (Gjermani, Francë, Austri, Belgjikë dhe Turqi).⁹⁹ Për më tepër, rrjeti diplomatik i Kosovës duhet të zgjerohet duke emëruar atashe policorë edhe në vende të tjera si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, Itali, vendet rajonale të Ballkanit Perëndimor, shtetet skandinave, shtetet baltike dhe në vende të tjera për thellimin e bashkëpunimit me këto shtete. Kjo do të duhej të kontribuonte në forcimin e bashkëpunimit bilateral të Kosovës me këto shtete dhe do të ndikonte në mbështetjen më të madhe të këtyre vendeve ndaj anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL dhe në organizatat tjera rajonale e ndërkombëtare të sigurisë.

Ndërsa, niveli i dytë i bashkëpunimit do të duhej të përfshinte fuqizimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe ndërshtetërore të Kosovës me vendet të cilat e kanë njohur shtetësinë e Kosovës. Drejtuesit e MPJ-së dhe të MPB-së si dhe ambasadoret e diplomatët e Kosovës jashtë vendit duhet të vendosin kontakte dhe të kenë takime të

97 (Qeveria e Kosovës, 2014, f. 29).

98 Po aty, f. 27.

99 (Ministria e Punëve të Brendshme, 2014, f. 5).

shpeshhta me përfaqësuesit e shteteve që janë të përfaqësuar në Komitetin Ekzekutiv dhe Asamblenë e Përgjithshme të INTERPOL-it për të lobuar për rastin e anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me përfaqësuesit e shteteve të këtyre mekanizmave të INTERPOL-it, diplomacia kosovare duhet të këmbëngul në shtyrjen përpara të agjendës për anëtarësimin e vendit në INTERPOL. Kjo duhet të bëhet me qëllim të vendosjes së kësaj çështjeje në agjendën e Komitetit Ekzekutiv të INTERPOL-it, por vetëm pasi institucionet kosovare të sigurohen se do ta fitojnë përkrahjen e përfaqësuesve të shteteve në Komitetin Ekzekutiv për të kaluar më pas votimi për anëtarësimin e Kosovës në Asamblenë e Përgjithshme të INTERPOL-it. Përveç kësaj, ministri i Punëve të Jashtme pasuar nga ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës duhet të zhvillojnë takime më të shpeshhta me Sekretarin e Përgjithshëm të INTERPOL-it për të sensibilizuar nevojën e anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL.

Krahas këtyre çështjeve, institucionet e Kosovës që kanë për detyrë përgatitjen e vendit për anëtarësim me të drejta të plota në INTERPOL duhet të argumentojnë fuqishëm të drejtën e Kosovës për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare. Në vijim të kësaj, argumentet juridike të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) lidhur me opinionin e saj këshillëdhënës për shpalljen e pavarësisë së Kosovës¹⁰⁰ dhe të Divizionit të Çështjeve Ligjore të UEFA-s¹⁰¹ kanë dëshmuar se për Kosovën nuk ekzistojnë pengesa juridike për të kërkuar anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare. Derisa pavarësia e Kosovës ishte shpallur në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe duke e marrë parasysh faktin që organizatat ndërkombëtare nuk njohin shtete, atëherë diplomacia e Kosovës duhet të shtjerr të gjitha mundësitë dhe përparësitë që i gëzon për të arsyetuar me argumente juridike anëtarësimin në INTERPOL. Në këtë mënyrë, do të mund të amortizohej edhe kundërshtimi i përfaqësuesve të shteteve anëtare të INTERPOL-it që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës për të mos votuar kundër Kosovës në Komitetin Ekzekutiv dhe Asamblenë e Përgjithshme të INTERPOL-it. Përparësi në këtë rrafsh është edhe argumenti shtesë se për t'u anëtarësuar në INTERPOL nuk kërkohet dhe nuk është kusht për Kosovën të jetë shtet anëtar i OKB-së.

2.3.2. Skenari i dytë

Në pamundësi të realizimit të skenarit të parë, institucionet e Kosovës duhet të gjejnë opsione të tjera politike për të vënë në agjendën e Komitetit Ekzekutiv dhe Asamblesë së Përgjithshme të INTERPOL-it kërkesën e Kosovës për anëtarësim në këtë organizatë ndërkombëtare. Siç është zërthyer në këtë hulumtim, ka shumë shtete të forta dhe me ndikim¹⁰² që përkrahin fuqishëm anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL. Kjo do të

100 (International Court of Justice, 2010).

101 (Reuters, 2016).

102 Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Gjermania, Franca, Italia, Belgjika, Austria dhe vende të tjera të anëtare të INTERPOL-it që kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

duhej t'i shërbente institucioneve të Kosovës për intensifikimin e përpjekjeve drejt anëtarësimit në këtë organizatë ndërkombëtare.

Për të përfunduar ciklin e shtet-ndërtimit, ku njëra prej fazave të rëndësishme është edhe anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare, institucionet e Kosovës duhet të shtjerrin të gjitha mundësitë që do të çonin drejt anëtarësimit në INTERPOL. Në rast të dështimit të kërkesës për anëtarësim në INTERPOL, atëherë MPJ-ja dhe mekanizmat tjerë përkatës duhet të kërkojnë që Kosovë të aplikojë në INTERPOL përmes ndonjë shteti anëtar të INTERPOL-it që ka njohur pavarësinë e Kosovës. Në këtë drejtim, diplomacia e Kosovës duhet të zgjerojë bashkëpunimin me diplomacinë e Shqipërisë që kërkesa për anëtarësim në INTERPOL të bëhet përmes ndonjë shteti përkrahës të Kosovës që ka peshë në INTERPOL, qoftë përmes Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe ose ndonjë shteti tjetër nga radhët e BE-së.

Duke e marrë parasysh faktin që pikëpamjet profesionale të anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL gëzojnë përkrahje të fuqishme tek shumë shtete që e përkrahin Kosovën, atëherë institucionet e vendit duhet të përgatitin një platformë për të aplikuar në INTERPOL përmes një shteti përkrahës të Kosovës. Për më tepër, do të duhej të argumentohej se rëndësia e anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL mbështetet mbi nevojën e institucioneve të Kosovës për të shkëmbyer informacione me INTERPOL-in dhe shtetet anëtare të kësaj organizate me qëllim të sundimit të ligjit. Për të fuqizuar bashkëpunimin me shtetet që deri më tani e kanë përkrahur Kosovën, institucionet përkatëse të Kosovës duhet të arrijnë marrëveshje për bashkëpunim policor me ato shtete me të cilat nuk ka marrëveshje të tilla. Kjo do të forconte edhe më shumë kërkesën e Kosovës për anëtarësim në INTERPOL dhe do të mund të lehtësonte rrugën e saj drejt anëtarësimit në INTERPOL nëse aplikimi do të bëhej nga ndonjëri prej këtyre shteteve.

Kërkesa e shteteve të përhershme të KS të OKB-së, që kanë njohur pavarësinë e Kosovës, se UNMIK-u duhet të bartë autorizimet sa i përket bashkëpunimit policor tek institucionet e Kosovës është një argument tjetër në favor të kërkesës për anëtarësim në INTERPOL. Kjo përkrahje duhet të shfrytëzohet nga Qeveria e Kosovës, e cila në bashkëpunim me shtetet mbështetëse duhet të arsyetojë në mënyrë të qartë qëllimin e anëtarësimit në INTERPOL. Kjo për shkakun se komunikimi i institucioneve të Kosovës me INTERPOL-in përmes misionit të UNMIK-ut nuk është i kënaqshëm¹⁰³ dhe rrjedhimisht vendi duhet të anëtarësohet në këtë organizatë ndërkombëtare të bashkëpunimit policor për vendosjen e kontakteve të drejtpërdrejta me mekanizmat e INTERPOL-it.

Opsioni i aplikimit në INTERPOL përmes një shteti tjetër përkrahës të Kosovës duhet të sigurojë që kërkesa e Kosovës për anëtarësim do të shqyrtohet nga mekanizmat vendimmarrës të INTERPOL-it (Komiteti Ekzekutiv dhe Asambleja e Përgjithshme). Krahas kësaj, vendosja e kërkesës së Kosovës për anëtarësim në agjendën e INTERPOL-

103 Intervistë me një zyrtar të lartë të Qeverisë së Kosovës, 20 shtator 2016.

it (përmes një shteti tjetër) duhet të garantojë se Kosova do t'i ketë votat e mjaftueshme dhe të nevojshme për t'u bërë shtet anëtar i INTERPOL-it. Ky proces përmes skenarit të dytë, në fund, duhet ta çojë Kosovën drejt anëtarësimit në INTERPOL me të drejta të plota sikurse shtetet tjera sovrane.

REKOMANDIME

- Qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje që t'i shmanget Marrëveshjes së Brukselit për përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal me Serbinë si referencë për t'u anëtarësuar në organizatat rajonale të sigurisë. Në vend të kësaj, duhet ta zbeh rolin e saj në atë mënyrë që të mos lejojë dykuptimësi të statusit të saj politik, ashtu siç po ndodh aktualisht si pasojë e pranisë së fustotës, e cila përmban Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që i vihet emrit zyrtar të Kosovës.
- Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme duhet të krijojnë një grup koordinues për të harmonizuar veprimet sa i përket lobimit për anëtarësimin e Kosovës në nismat dhe organizatat rajonale e ndërkombëtare të sigurisë.
- Ekzekutivi kosovar duhet të hartojë një strategji me objektiva, afat të saktë kohor dhe aktivitete konkrete sa i përket avancimit të statusit të Kosovës në nismat dhe organizatat e sigurisë ku e ka rolin e anëtarit të "asociuar" apo është vetëm "observues". Pas kësaj, Qeveria e vendit duhet të fillojë procesin e aplikimeve për anëtarësim të plotë duke e përdorur si argument anëtarësimin në nismën për Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECp).
- Procesi i anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL dhe në organizatat tjera ndërkombëtare të sigurisë duhet të udhëhiqet nga Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës. Duhet të ndryshohet praktika e deritanishme ku rolin udhëheqës për anëtarësim në INTERPOL e ka pasur Ministria e Punëve të Brendshme.
- Ministria e Punëve të Jashtme duhet të zgjerojë në mënyrë sistematike bashkëpunimin me Ministrinë e Punëve të Brendshme për bashkërendimin e të gjitha aktiviteteve me synim të anëtarësimit në INTERPOL. Në këtë drejtim, fushatat për të lobuar në favor të anëtarësimit në INTERPOL duhet të shtrihen në disa drejtime përmes aktiviteteve të përbashkëta të këtyre dy ministrive si në vijim:
 - Me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit bilateral me vendet tjera në fushën e sigurisë, institucionet e Kosovës duhet të emërojnë atashë policorë në misionet diplomatike të Kosovës, gjegjësisht në vendet që kanë njohur pavarësinë e Kosovës, krahas pesë vendeve të tjera ku atashetë policorë tashmë janë emëruar.
 - Të ketë kontakte dhe takime më të shpeshta të zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe diplomatëve të ambasadave të Kosovës me përfaqësuesit e shteteve, të cilët janë të përfaqësuar në Komitetin Ekze-

ktiv dhe Asamblenë e Përgjithshme të INTERPOL-it si dhe me Sekretarin e Përgjithshëm të INTERPOL-it. Në këtë mënyrë, duhet të ketë lobim të fuqishëm në INTERPOL nga ana e institucioneve kosovare në bashkëpunim me shtetet përkehëse të Kosovës për të shtyrë përpara agjendën e anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL në organet vendimmarrëse të kësaj organizate.

- Të argumentohet në pikëpamje profesionale e drejta e Kosovës, veçanërisht nevoja e Policisë së Kosovës për anëtarësim në INTERPOL. Për këtë institucionet kosovare të bashkëpunojnë ngushtë me shtetet që kanë njohur pavarësinë e Kosovës.
- Diplomacia kosovare, në bashkëpunim të ngushtë me vendet mbështetëse të INTERPOL-it, duhet të sigurohet që do t'i ketë votat e mjaftueshme në Komitetin Ekzekutiv të INTERPOL-it për të kaluar çështja e anëtarësimit të Kosovës në Asamblenë e Përgjithshme të INTERPOL-it. Njëjtë të vepohet kur të vendoset kjo çështje në agjendën e Asamblesë së Përgjithshme. Për arritjen e këtyre qëllimeve duhet të shtohet numri i njohjeve ndërkombëtare të shtetësisë së Kosovës nga ato vende që nuk e kanë njohur ende Kosovën.
- Të argumentohet në pikëpamje juridike e drejta e Kosovës për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, përfshirë INTERPOL-in. Mendimi këshillëdhënës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për pavarësinë e Kosovës dhe argumentet juridike me rastin e pranimit të Kosovës në UEFA dhe FIFA duhet t'i shërbejnë si përparësi diplomacisë kosovare për të kundërshtuar përpjekjet e Serbisë kundër anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL.
- Institucionet e Kosovës duhet të ofrojnë arsyet dhe argumentet e duhura profesionale për anëtarësim në INTERPOL. Pamundësia e institucioneve të zbatimit të ligjit në Kosovë për të luftuar kriminelët dhe grupet e krimit të organizuar të nivelit trans-nacional si dhe nevoja për të shkëmbimin e informatave me INTERPOL-in është argumenti mbase më i fuqishëm për anëtarësim në këtë organizatë me qëllim të sundimit të ligjit dhe luftimit të krimeve të ndryshme brenda dhe jashtë Kosovës. Profesionalizimi i Policisë së Kosovës dhe gatishmëria e saj për anëtarësim INTERPOL, e konfirmuar nga EULEX-i, është argument tjetër profesional për nevojën e Kosovës për t'u bërë pjesë e INTERPOL-it.
- Komunikimi dhe kontakti i tërthortë i institucioneve të Kosovës me INTERPOL-in, të cilin e zhvillojnë përmes zyrës së INTERPOL-it në misionin e UNMIK-ut dhe Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovë duhet të avancohet në kontakt të drejtpërdrejtë të Kosovës me INTERPOL-in. Kjo do të arrihet vetëm atëherë kur Kosova të anëtarësohet në INTERPOL. Si rrjedhojë, Memorandumi i Mirëkuptimit, ndërmjet UNMIK-ut dhe INTERPOL-it, që është ende në fuqi, është bërë i panevojshëm për shkak të pamundësisë së Kosovës për të shkëm-

byer informacione drejtpërdrejtë me INTERPOL-in. Prandaj, nuk ka arsye të vënohet edhe më tej procesi i anëtarësimit në INTERPOL, ndërsa UNMIK-u nuk duhet të pengojë anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare.

- Arrestimi i qytetarëve të Kosovës, gjegjësisht zyrtarëve të institucioneve të Kosovës (nga Serbia dhe vendet tjera), si rrjedhojë e fletë-arresteve të INTERPOL-it të lëshuara më kërkesë të Serbisë, është duke tensionuar marrëdhëniet edhe ashtu shumë të brishta në mes të Kosovës dhe Serbisë. Nisur nga fakti që fletë-arrestet e lëshuara ndaj zyrtarëve të institucioneve të Kosovës dhe veçanërisht ndaj ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë të motivuara politikisht nga lufta e Kosovës, Qeveria e Kosovës, derisa vendi të anëtarësohet në INTERPOL, duhet të kushtëzojë dialogun me Serbinë, të ndërmjetësuar nga BE-ja, me heqjen e këtyre fletë-arresteve nga ana e Serbisë. Përveç kësaj, Qeveria e Kosovës duhet të kërkojë nga bashkësia ndërkombëtare t'i bëjë presion Serbisë që të heq nga lista e personave të kërkuar ndërkombëtarisht qytetarët e Kosovës, për ndjekjen dhe hetimin e të cilëve Serbia nuk ka mbështetje juridike ose penale.

BIBLIOGRAFIA

Dokumentet dhe publikimet zyrtare të INTERPOL-it:

- Constitution of the ICPO-INTERPOL [I/CONS/GA/1956(2008)]. Qasur më 25 korrik 2016, në: <http://www.interpol.int/About-INTERPOL/Legal-materials/The-Constitution>
- Fact Sheet – INTERPOL: an overview, COM/FS/2015-02/GI-01. Qasur më 26 korrik 2016, në: <http://www.interpol.int/News-and-media/Publications2/Fact-sheets2>
- INTERPOL, “About INTERPOL”. Qasur më 26 korrik 2016, në: <http://www.interpol.int/About-INTERPOL/Priorities>
- INTERPOL, “Crime Areas”. Qasur më 27 korrik 2016, në: <http://www.interpol.int/Crime-areas>
- INTERPOL, “Executive Committee”. Qasur më 29 gusht 2016, në <http://www.interpol.int/About-INTERPOL/Structure-and-governance/Executive-Committee>
- INTERPOL, “History”. Qasur më 25 korrik 2016, në: <http://www.interpol.int/About-INTERPOL/History>
- INTERPOL, “Member Countries”. Qasur më 25 korrik 2016, në: <http://www.interpol.int/Member-countries/World>
- Memorandum of Understanding between the International Criminal Police Organization-INTERPOL and the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo on Co-operation in Crime Prevention and Criminal Justice. Qasur më 27 korrik 2016, në: <http://www.interpol.int/About-INTERPOL/Legal-materials/International-Cooperation-Agreements>
- Rules of Procedure of the ICPO-INTERPOL General Assembly [II.A/RPGA/GA/1996(2004)]. Qasur më 9 tetor 2016, në: <http://www.interpol.int/About-INTERPOL/Legal-materials/Fundamental-texts>

Dokumentet dhe publikimet zyrtare të institucioneve të Kosovës:

- Government of the Republic of Kosovo. (20 prill 2011). “Memorandum of Understanding for coordination and support provided for International Law Enforcement Coordination Unit (ILECU).” Qasur më 28 korrik 2016, në: <http://www.psh-ks.net/repository/docs/ILECU.pdf>

- Kontribute të mbledhura nga raportimi i ministrit të Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni, në Komisionin parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, 19 korrik 2016.
- Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë.
- Lista e marrëveshjeve të nënshkruara nga Qeveria e Kosovës me vendet e tjera. Qasur më 12 tetor 2016, në: http://www.mei-ks.net/repository/docs/Aneksi_D_-_Lista_e_Marreveshjeve_Nderkombetare_te_Qeverise_se_Kosoves%5B1%5D.pdf
- Marrëveshja e Brukselit – Konkluzionet e dakorduara. (24 shkurt 2012). *“Aranzhimet lidhur me Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal”*. Qasur më 11 tetor 2016, në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Konkluzionet_0210_arranzhime.pdf
- Ministria e Punëve të Brendshme. (Prill 2014). *“Buletini i MPB-së”*. Buletin mujor, nr. 7. Qasur më 15 shtator 2016, në: https://www.mpb-ks.org/repository/docs/Buletini_i_MPB-se,_01.04.2014.pdf
- Ministria e Punëve të Brendshme. (30 shtator 2016). *“Ministri Hyseni priti në takim ministrin e Punëve të Jashtme Enver Hoxhaj”*. Qasur më 30 shtator 2016, në: <http://mpb.rks-gov.net/News.aspx?ID=683>
- Ministria e Punëve të Jashtme. (18 gusht 2015). *“Austria mbështet anëtarësimin e Kosovës në UNESCO dhe Interpol”*. Qasur më 14 shtator 2016, në: <http://www.mfa-ks.net/?page=1,217,2744>
- Ministria e Punëve të Jashtme. (24 qershor 2016). *“Hoxhaj dhe Hyseni koordinohen për politikën e jashtme në fushën e sigurisë”*. Qasur më 14 shtator 2016, në: <http://www.mfa-ks.net/?page=1,217,3536>
- Policia e Kosovës. (Prill 2016). *“Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar – SOCTA 2014-2015”*. Qasur më 24 shtator 2016, në: http://www.kosovopolice.com/repository/docs/VLER%C3%8BSIMI_I_K%C3%8BRC%C3%8BNIMIT_NGA_KRIMET_E_R%C3%8BNDA_DHE_KRIMI_I_ORGANIZUAR_%E2%80%93_SOCTA,_2014-2015.pdf
- Qeveria e Kosovës. (Mars 2014). *“Analizë e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës”*. Qasur më 10 shtator 2016, në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Analiza_e_Rishikimit_Strategjik_te_Sektorit_te_Sigurise_se_RKS_06032014.pdf

Dokumentet dhe publikimet zyrtare ndërkombëtare:

- *“EULEX project to support Kosovo in their efforts to become an INTERPOL-Member”*, 18 mars 2015.

- FRONTEX, “FRONTEX Signs Working Arrangement with Kosovo”, 25 maj 2016. Qasur më 11 tetor 2016, në: <http://frontex.europa.eu/news/frontex-signs-working-arrangement-with-kosovo-u1FpiJ>
- FRONTEX, “Management Board”. Qasur më 24 shtator 2016, në: <http://frontex.europa.eu/about-frontex/organisation/management-board/>
- International Court of Justice. (2010). “*Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo*”, Advisory Opinion of 22 July 2010. Qasur më 15 shtator 2016, në: <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15987.pdf>
- United Nations, “Member States”. Qasur më 8 shtator 2016, në: <http://www.un.org/en/member-states/index.html>
- United Nations, Security Council, 7448th meeting, 26 maj 2015a. S/PV.7448. Qasur më 12 shtator 2016, në: http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/PV.7448
- United Nations, Security Council, 7510th meeting, 21 gusht 2015b. S/PV.7510. Qasur më 11 shtator 2016, në: http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/PV.7510
- United Nations, Security Council, 7637th meeting, 29 shkurt 2016a. S/PV.7637. Qasur më 12 shtator 2016, në: http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/PV.7637
- United Nations, Security Council, 7760th meeting, 25 gusht 2016b. S/PV.7760. Qasur më 12 shtator 2016, në: http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/PV.7760
- United Nations Office on Drugs and Crime. (2015). “*Drug Money: the illicit proceeds of opiates trafficked on the Balkan route.*” Vienna: United Nations Office on Drugs and Crime. Qasur më 16 shtator 2016, në: https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Studies/IFF_report_2015_final_web.pdf
- UNMIK, “Rule of Law”. Qasur më 27 korrik 2016, në: <http://www.unmikonline.org/Pages/rollo.aspx>.

Publikime të ndryshme:

- Emini, D. (2014). “*Anëtarësimi dhe përfaqësimi i Kosovës në nismat rajonale të sigurisë*”. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Qasur më 29 shtator 2016, në: http://www.qkss.org/repository/docs/An%C3%ABtar%C3%ABsimi_dhe_p%C3%ABrfaq%C3%ABsimi_i_Kosov%C3%ABs_n%C3%AB_nismat_rajonale_t%C3%AB_siguris%C3%AB_829083.pdf

- KosovoThanksYou, *"Who Recognized Kosovo as an Independent State?"*. Qasur më 20 tetor 2016, në: <http://www.kosovothanksyou.com/>
- Krasniqi, A. (2016). *"Çka shkoi ters me anëtarësimin në UNESCO?"* Prishtinë: Ec Ma Ndryshe & KFOS. Qasur më 9 shtator 2016, në: http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/160414181023_FINAL_1_Analize_e_Shkurter_UNESCO_Shqip.pdf
- Kursani, Sh. (2015). *"Bashkëpunimi policor mes Kosovës dhe Serbisë"*. Beograd dhe Prishtinë: Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë & Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Qasur më 15 shtator 2016, në: http://www.qkss.org/repository/docs/Bashkepunimi_policor_ne_mes_te_Kosoves_dhe_Serbise_856214.pdf
- Prezelj, I. (2013). "Challenges of Multilateral Regional Security and Defence Cooperation in South East Europe". *European Perspectives – Journal on European Perspectives of the Western Balkans*, Vol. 5 No. 2(9), pp. 83 – 112.
- Qehaja, F. (16 prill 2016). *"Radha e INTERPOL-it"*. Sbunker. Qasur më 5 shtator 2016, në: <https://sbunker.net/op-ed/75980/radha-e-interpol-it/>
- West, L., Founds, E., & Merja, A. (2015). *"Mbushja e hendekut: Afrimi i Kosovës me organizatat e bashkëpunimit ndërkombëtar policor."* Prishtinë: Grupi për Studime Juridike dhe Politike & Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese. Qasur më 8 shtator 2016, në: http://drejtesianekosove.com/repository/docs/raporti_shqip_final__885930.pdf

Burimet e shfrytëzuara nga mediat:

- InSerbia Network Foundation, *"Stefanovic: Kosovo's admission to Interpol unacceptable"*, 17 gusht 2015. Qasur më 12 shtator 2016, në: <https://inserbia.info/today/2015/08/stefanovic-kosovos-admission-to-interpol-unacceptable/>
- Koha Net, *"Blinken: SHBA përkrah anëtarësimin e Kosovës në UNESCO dhe INTERPOL"*, 1 tetor 2015a. Qasur më 14 shtator 2016, në: <http://koha.net/?id=1&l=77414>
- Koha Net, *"Diplomacia e dështimeve"*, 15 nëntor 2015b. Qasur më 13 shtator 2016, në: <http://koha.net/?id=27&l=84287>
- Koha Net, *"Kosova ka nevojë të anëtarësohet në Interpol"*, 14 mars 2016a. Qasur më 5 tetor 2016, në: <http://koha.net/?id=27&l=103151>
- Koha Net, *"Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Kosovës e FRONTEX-it"*, 25 maj 2016b. Qasur më 11 tetor 2016, në: <http://koha.net/?id=27&l=115078>
- Koha Net, *"Gavriq dënohet me 13 vjet burgim për terrorizëm"*, 29 qershor 2016c. Qasur më 11 tetor 2016, në: <http://koha.net/?id=3&l=121060>

- Koha Net, *"Ministri Hyseni lëshon mbledhjen në Sllovaki – u prezantua me 1244"*, 20 shtator 2016d. Qasur më 24 shtator 2016, në: <http://koha.net/?id=27&l=133524>
- KTV – KohaVision, *"Speciale – Pranimi i Kosovës në UEFA"*, 3 maj 2016a. Qasur më 9 shtator 2016, në: <https://www.youtube.com/watch?v=5PODYbi9BPI>
- KTV – KohaVision, *"Puls – Kosova dhe Bashkimi Evropian"*, 20 qershor 2016b. Qasur më 30 gusht 2016, në: <https://www.youtube.com/watch?v=N2bndFLyZ18>
- Radio Evropa e Lirë, *"Kosova pret anëtarësim në UNESCO, por jo edhe në INTERPOL"*, 19 gusht 2015. Qasur më 12 shtator 2016, në: <http://www.evropaelire.org/a/27197589.html>
- Radio Evropa e Lirë, *"Kosova "e vetmuar" në luftën rajonale kundër terrorizmit"*, 7 qershor 2016a. Qasur më 5 korrik 2016, në: <http://www.evropaelire.org/a/27783771.html>
- Radio Evropa e Lirë, *"Kosova larg anëtarësimit në INTERPOL"*, 23 shtator 2016b. Qasur më 24 shtator 2016b, në: <http://www.evropaelire.org/a/28007257.html>
- Radio Televizioni Dukagjini, *"Personale – Enver Hoxhaj"*, 16 korrik 2016. Qasur më 11 gusht 2016, në: https://www.youtube.com/watch?v=h_fnZETkZE
- Reuters, *"Kosovo joins UEFA and seeks FIFA membership too"*, 3 maj 2016. Qasur më 15 shtator 2016, në: <https://www.youtube.com/watch?v=G78rbkdt9-A>
- Telegrafi, *"Kështu e kalojnë kosovarët kufirin Serbi – Hungari (Video)"*, 2015 Qasur më 11 tetor 2016, në: <http://www.telegrafi.com/keshtu-e-kalojne-kosovaret-kufirin-serbi-hungari-video/>
- Telegrafi, *"Franca përkrah Kosovën në procesin e liberalizimit të vizave"*, 2016 Qasur më 14 shtator 2016, në: <http://www.telegrafi.com/franca-perkrah-kosoven-ne-procesin-e-liberalizimit-te-vizave/>
- Zëri, *"Gjermanët premtojnë ndihmë për anëtarësimit të Kosovës, në Interpol dhe Europol"*, 18 qershor 2015. Qasur më 14 shtator 2016, në: <http://zeri.info/aktuale/37694/gjermanet-premtojne-ndihme-per-anetaresimit-te-kosoves-ne-interpol-dhe-europol/>

Intervistat:

- Arbër Gegaj, Udhëheqës i Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë, 14 korrik 2016.
- Carsten Twelmeier, Këshilltar i lartë për polici në UNMIK, 31 mars 2016.
- Kushtrim Istrefi, Njohës i së drejtës ndërkombëtare, 18 gusht 2016.
- Nuredin Ibishi, Anëtar i Komisionit parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 21 qershor 2016.
- Shqipe Mjekiqi, Këshilltare e lartë politike e ministrit të Punëve të Brendshme, 14 qershor 2016.
- Intervistë me një zyrtar të lartë të Qeverisë së Kosovës, 20 shtator 2016.
- Intervistë me një zyrtar të lartë të UNMIK-ut, 17 qershor 2016.
- Komunikim përmes shkrimit me zëvendësministrin e Punëve të Brendshme, Valdet Hoxha, 12 tetor 2016.

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

327(496.51:4)

Aliu, Leonora

Nyja e Gordianit : pengesat e Kosovës për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare të sigurisë : rasti i INTERPOL-it / Leonora Aliu, Plator Avdiu. – Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2016. – 44 f. ; 21 cm.

Bibliografia : f. 37-42

1.Avdiu, Plator

ISBN-978-9951-679-47-3

ISBN 978-9951-679-47-3



9 789951 679473

www.qkss.org